



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 66/27 prot.

Tiranë më, 25.07.2024

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT Z. SAMI ILJAZ KUTI

Nr. 37, datë 25.07.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Erjana Pjetri
Ersa Karaj
Klevis Dhigoi

Kryesuese
Relatore
Anëtar

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, znj. **Lediana Azemaj**, më datë 25.07.2024, ora 10:00, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTIT TË VLËRËSIMIT: Sami Iljaz Kuti, me funksion Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Gardës së Republikës së Shqipërisë.

OBJEKTI: Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

Rregullore Nr. 197, datë 28.02.2023 “Për hapat proceduralë të unifikuar”.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes Ersja Karaj, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoi subjektin e vlerësimit z. Sami Kuti, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi Sami Iljaz Kuti është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 04.07.2023, si Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, pranë Gardës së Republikës.
3. Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës Nr. **, datë 02.02.2024, gjatë fazës së hetimit administrativ, z. Sami Kuti, është transferuar dhe emëruar me detyrë Zëvendës drejtor i Përgjithshëm në Gardën e Republikës, funksion organik i parashikuar në nenin 6, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
4. Me Urdhër të Ministrit të Brendshëm Nr. **, datë 31.05.2024, Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës së Shqipërisë, Drejtuesi i Parë Sami Kuti, është caktuar për ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë.
5. Subjekti i vlerësimit, z. Sami Iljaz Kuti, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar më datë 04.07.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr. 07, datë 17.01.2023, “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.

6. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin Nr. ** datë 24.07.2023 u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit e përbërë nga: znj. Erjana Pjetri (Kryesuese), znj. Ersja Karaj (Relatore) dhe z. Klevis Dhigoi (Anëtar).
7. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”, me Vendimin Nr. *** prot., datë 24.07.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Sami Iljaz Kuti.
8. Relatori i çështjes, znj. Ersja Karaj, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 25.07.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
9. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar nëpërmjet postës elektronike deklaratën për konfliktin e interesit në datën 27.07.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
10. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit Nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
11. Në vijim të procesit për subjektin e vlerësimit z. Sami Kuti, mbështetur në nenin 33/1, nenin 42 dhe nenin 46, të Ligjit Nr.12/2018 i ndryshuar, relatori i çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse, si më poshtë vijon:
 - Formularin e deklarimit të pasurisë dhe dokumentacioni shoqërues, me shkresën Nr. *** Prot., datë 25.07.2023, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI).
 - Formularin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale me shkresë përcjellëse Nr. *** Prot., datë 25.07.2023, pranë Gardës së Republikës.
 - Formularin e Kontrollit të Figurës me shkresë përcjellëse Nr. *** Prot., datë 25.07.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
12. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, Trupa e Vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
13. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve, bazuar në nenin 4 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka për objekt:

- Vlerësimin e pasurisë

- Kontrollin e figurës
- Vlerësimin e aftësive profesionale.

14. Trupa e Vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- a. Ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar;
- b. Ligjin nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
- c. Ligjin nr. 40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”;
- d. Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;
- e. Udhëzim i Ministrit të Brendshëm Nr. 07, datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”;
- f. Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe ILDKPKI Nr. 15, datë 27.01.2023, “Për miratimin e formularëve të deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik, si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar;
- g. Rregulloren nr. 197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”.

15. Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet e rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- ❖ *Deklaratën e Pasurisë;*
- ❖ *Deklaratën për Kontrollin e Figurës;*
- ❖ *Formularin e Vlerësimit Profesional;*
- ❖ *Dokumentacionin bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet;*
- ❖ *Aktin e përfundimit të vlerësimit të pasurisë, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;*
- ❖ *Raportin mbi vlerësimin e aftësive profesionale, nga Garda e Republikës;*
- ❖ *Raportin mbi Kontrollin e Figurës, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore;*
- ❖ *Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;*
- ❖ *Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit;*
- ❖ *Bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*

16. Trupa e Vlerësimit, më datë 10.07.2024, pasi dëgjoji relatorin dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të

aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Sami Kutu me Vendimin Nr. **, datë 10.07.2024, vendosi:

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Sami Iljaz Kutu;
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:

- *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
- *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët; vlerësimin pasuror, kontrollin e figurës dhe atë profesional.*

- c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të Ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47, të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime

17. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pikat 12 dhe 14, të Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, si dhe nenit 3, pika 11 dhe nenit 5, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”.

II. SEANCA DËGJIMORE

18. Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit Sami Kutu, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe Kodin e Procedurave Administrative, në datë 19.07.2024 në ambientet e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, Tiranë.

19. Në këtë seancë subjekti i vlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer duke kërkuar konfirmimin në detyrë.

20. Trupa e Vlerësimit zhvilloi seancën e dhënies së vendimit më datë 25.07.2024.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

21. Subjekti i vlerësimit z. Sami Iljaz Kutu, ka qenë bashkëpunues dhe korrekt gjatë gjithë procesit të vlerësimit në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

22. Subjekti ka paraqitur që në fazën e dorëzimit të deklaratave dokumentacion shoqërues të vlerësuar nga ana e tij, si dhe gjatë fazës së hetimit administrativ, gjatë komunikimit dhe pyetjeve të drejtuara, është përgjigjur dhe ka përcjellë dokumentacion shoqërues/justifikues

shtesë, me qëllim vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, sipas rastit dhe rrethanave të tjera të çështjes për sqarim.

IV. PROCESI I VLERËSIMIT NGA TRUPA E VLERËSIMIT

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, e veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre dhe përmbushjen e detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
24. Në zbatim të nenit 32, pika 2, e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit z. Sami Kutu ka dorëzuar deklaratën e pasurisë më datë 09.03.2023. Formulari i Pasurisë ka Nr. Indeksi **, viti 2023.
25. Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga Trupa e Vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
26. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
27. Trupa e Vlerësimit hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.
28. Gjithashtu, ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, shlyerjen e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.
29. **Trupa e Vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:**
 - Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
 - Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI në zbatim të neneve 33/1 dhe 34, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;
 - Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar;
 - Shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare;

- Dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit.

30. Hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit konsistoi në:

- Verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar;
- Verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruar si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- Evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

31. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja:

31.1 Sami Kuti nuk ka qenë dhe nuk është subjekt deklarues në ILDKPKI.

31.2 ILDKPKI-ja, në përputhje me Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport të hollësishëm, Nr. *** prot., datë 19.01.2024, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Sami Kuti, ku është konstatuar:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burime të ligjshme financiare;
- b) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk është kryer fshehje e pasurisë;
- d) nuk është kryer deklarim i rremë;
- e) subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

DEKLARIM I PASURIVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT, SAMI ILJAZ KUTI

32. Pasuria Nr. 1

Bashkëpronar i pasurisë së paluajtshme, në Njësinë Administrative nr. **, rruga “****” Tiranë, zk. ***, nr. ****, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 500 m², sipërfaqja e ndërtimit 174.2 m², sipërfaqja totale e ndërtimit për banim 198.9 m², për aktivitet 88.1 m², përfituar me vendim legalizimi nr. ****, datë 03.02.2023, nga ASHK Drejtoria Tirana Jug.

Burimi i krijimit: daton me privatizimin nga Komunale Banesa nr. **, Tiranë, me kontratë shitje, datë 06.08.1996, nr. *** rep., nr. *** kol., hipotekë nr.***, datë 06.08.1996, për sipërfaqe trualli 212 m², nga e cila ndërtesë 70 m² (në bashkëpronësi të Sami dhe Vehbiye Kutit, nga ½ pjesë secili). Me kontratë shitblerje, datë 21.12.2004, nr. *** rep., nr. *** kol., hipotekë datë 30.12.2004, bëhen bashkëpronarë edhe vëllai B. Kuti dhe bashkëshortja e tij V. Kuti, duke

zotëruar në këtë mënyrë ¹/4 pjesë secili (certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 15.05.2014, nga ZVRPP Tiranë, për pasurinë nr. ***, zk. ***, rruga ****, Tiranë), pasi në vitin 1997 prindërit dhe familja e vëllait, shitën shtëpinë në fshatin Dramosh, Shkodër, u transferuan në Tiranë dhe në pronën e mësipërme u ndërtua shtëpi banimi dhe bodrum, për të cilën u investua në vite. E gjithë punëtoria për shtëpinë është bërë nga prindërit, familja e vëllait dhe me ndihmën tonë, të afërmeve e të njohurve tanë. Objekti është deklaruar për legalizim me vetë deklaram nr. ***, datë 21.08.2006, është aplikuar dhe legalizuar në vitin 2023, me vendimin nr. ****, datë 03.02.2023.

Vlera e privatizimit: 27.935 lekë. Vlera e preventivuar 1.576.476 lekë.

Pjesa takuese: 25%.

32.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë dokumentacionin:

- a. Kontratë shitje, datë 06.08.1996.
- b. Vërtetim nga dokumenti hipotekor, datë 03.11.2003. Bashkëlidhur praktika.
- c. Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.12.2004. Bashkëlidhur praktika.
- d. Vërtetim nga dokumenti hipotekor, datë 12.01.2005, për pasurinë me nr. ****, zk. ***.
- e. Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 15.02.2014. Bashkëlidhur praktika.
- f. Vetëdeklarim për legalizim, datë 08.08.2006.

HETIMI ADMINISTRATIV

32.2 Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara, mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, ILDKPKI dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, u kanë kërkuar informacion Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Regjistrat Notal, FSHU, 14 Shokërive Rajonale Ujësllës – Kanalizime, institucioneve bankare dhe jo-bankare, si dhe u janë drejtuar vetë subjektit. Nga përgjigjet e administruara dhe të analizuara, rezultoi:

32.3 ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Jug, me shkresën nr. *** prot., datë 04.09.2023, konfirmon pasurinë me nr. ***, vol. **, fq. ***, zk. *** (mbyllur), lloji truall, me sipërfaqe 212 m², në emër të Sami Kuti, Vehbi Kuti, B. K. dhe V. K., përfutur me kontratë shitje. Bashkëlidhur praktika.

32.4 Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim praktikën dhe dokumentacionin bashkëlidhur, nga ku rezulton si më poshtë:

32.5 Pasuria e sipërcituar është mbyllur dhe vijon në pasurinë nr. ***, vol. **, fq. **, zk. *** (aktive), truall me sipërfaqe 500 m² dhe ndërtesë 174.2 m², në emër të Sami, Vehbi, B. dhe V. Kuti, përfutur me vendimin nr. ****, datë 03.02.2023 “Për legalizimin e ndërtimit pa leje”. Bashkëlidhur praktika dhe dokumentacioni shoqëruar.

32.6 Referuar kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.12.2004, pala shitëse Sami dhe Vehbi Kuti i kanë shitur palës blerëse B. K. dhe V. K., pasurinë me nr. ****, zk.

, apartament (ish magazina e Gardës), me sipërfaqe trualli 212 m², nga kjo ndërtesë 70 m² dhe oborr 142 m², e ndodhur në rrugën **, Tiranë, në vlerën 500.000 lekë. Likuidimi është kryer jashtë zyrës noteriale. Blerësit bëhen bashkëpronarë të ½ pjesë të kësaj pasurie.

32.7 Sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor, datë 30.12.2004, pasuria e sipërcituar rezulton në emër të Sami Kuti, Vehbije Kuti, B. K. dhe V. K., me nga 1/4 pjesë takuese secili.

32.8 Më datë 08.08.2006, deklaruesit B. K. dhe Sami Kuti kanë bërë vetëdeklarim për legalizim, Njesisë Administrative nr. 5, me objekt shtëpi banimi dhe bodrum, rruga *****, pasuria me nr. *****, zk. ***. Bashkëlidhur praktika e Urdhërit nga ASHK, Drejtoria Tirana Jug, datë 01.02.2023, mbi ndryshimin e dokumentacionit teknik dhe ligjor të treguesve të pasurisë së vetë-deklaruar nga B. K., nr. ** prot., datë 19.01.2023.

32.9 Harta treguese e regjistrimit, datë 02.02.2023, konfirmon pasurinë. Kjo pasuri, sipas hartës treguese, rezulton se është ngjitur me pasurinë me nr. *****. *Foto të objektit.*

32.10 Nëpërmjet shkresës datë 07.02.2023, ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Jug, njofton shtetasin B. Kuti, se në zbatim të ligjit nr. 20/2020 dhe VKM nr. 488, datë 22.07.2014, është llogaritur vlera e parcelës ndërtimore për ndërtim pa leje me funksion banimi dhe të përzierë, të subjekteve që përfitojnë falje të pagesës, si dhe mënyra e afateve dhe pagesës.

32.11 Sipas faturës për arkëtim të pagesës së parcelës ndërtimore nga Drejtoria Aluizni Tiranë Jug, datë 07.02.2023, rezulton se B. Kuti ka kryer pagesë në vlerën 299.600 në bono dhe 215.712 në lekë, pranë Credins Bank, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 299 m².

32.12 Nëpërmjet deklaratës noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., datë 09.01.2023, pala deklaruese S. K., V. K., B. K. dhe V. K., deklarojnë se janë bashkëpronarë të pasurisë me nr. ****, zk. ****, truall 212 m², nga kjo ndërtesë 70 m² dhe deklarojnë se ndërtesa e vjetër është shembur për shkak të amortizimit dhe mbi truallin e pëshkruar më sipër kanë ndërtuar një Objekt të ri në vitin 1997 dhe kërkojnë nga ASHK Tiranë, të vijojë procedurat e legalizimit të objektit të ri.

32.13 ASHK, Drejtoria Tirana Jug, ka nxjerrë akt evidentimi nr. ***, datë 02.02.2023, për gjendjen ndërtimore në terren, të ndërtimit pa leje, në emër të Sami Kuti dhe B. K., ndërtim pa leje i kombinuar, 1 kat dhe 1 kat nëntokë. Bashkëlidhur praktika.

32.14 Nëpërmjet vendimit për legalizim nr. *****, datë 03.02.2023, ASHK, Drejtoria Tirana Jug, konfirmon pasurinë me nr. *****, zk. ****, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 500 m², ndërtimi 174.2 m², për banim 198.9 m², për aktivitet 88.1 m², 1 + 1 kat nëntokë, në emër të B. K., S. K., V. K dhe V. K. Bashkëlidhur praktika.

32.15 Referuar kartelës së pasurisë së paluajtshme, datë 28.03.2023, pasuria me nr. *****, zk. ****, e llojit truall me sipërfaqe 500 m², ndërtesë 174.2 m², e ndodhur në rrugën “*****” Tiranë, rezulton në emër të Sami dhe Vehbije Kuti, B. K. dhe V. K. Bashkëlidhur akti i fitimit të pronësisë “Vendim për kalim pronësie nga ASHK, nr. *****, datë 03.02.2023. Përshkrimi

*“Vendim nr. ***, datë 03.02.2023, Objekt i kombinuar 1k+1k nëntokë, kati nëntokë 88.1 m², soc. ekonomik, kati përdhe 174.2 m², verandë + shkallë 24.7 m²”.*

32.16 Në lidhje me pasurinë e deklaruar si më sipër, me inventarin e datës 05.01.2024, subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, se shtëpia ka filluar të ndërtohet në vitin 1997, kryesisht si karabina dhe kanë vazhduar së investuari deri rreth vitit 2002. Në pamundësi për të ndërtuar me një firmë ndërtimi, kanë blerë materialet ndërtimore, si dhe kanë përdorur materialet e nxjerra nga prishja e ndërtesës së vjetër. E gjithë punëtoria që nga themelet, është bërë me punën e jashtëzakonshme fizike, të përditshme, të prindërve të tij, vëllait, bashkëshortet në rolin e ndihmësve, por dhe me ndihmën e pakursyer të të afërmeve, shokëve e të njohurve. Sqaron se në këtë shtëpi kanë banuar që nga momenti i blerjes në vitin 1996 dhe në vazhdim, pavarësisht se kanë filluar ndërtimin e shtëpisë në vitin 1997 deri në vitin 2002. Vlera e preventivuar e shtëpisë prej 1.576.476 lekë rezulton nga preventivi i hartuar nga inxhinieri i licencuar V. K., referuar projektit dhe çmimeve të manualit të hartuar e miratuar nga instituti i studimeve e projekteve të mbrojtjes. Kontributi i familjes së tij në këtë pasuri ka qenë 50 % e vlerës së preventivuar të saj, pasi shpenzimet i ndanin përgjysmë me familjen e vëllait. Çdo punim, që nga fillimi dhe në vitet më pas, është bërë nga ana e tyre, duke siguruar sipas mundësisë materialet e nevojshme (në pamundësi të faturave të materialeve të blera në vitet më pas, përveç të atyre në fillim të ndërtimit), pasi ato bliheshin nga pak dhe në periudha të ndryshme të shtrira në vite. Duke qenë se, pas prishjes së ndërtesës së vjetër, shtëpia u ndërtua me kontributin e familjes së vëllait dhe familjes së tij, por në pamundësi juridike për të bërë ndarjen dhe regjistrimin e saj në hipotekë (duke qenë se ishte e pa legalizuar), proceduan me pronën që ishte e regjistruar në hipotekë dhe me kontratë shitje, datë 21 Dhjetor 2004, bëhen bashkëpronarë edhe vëllai B. Kuti dhe bashkëshortja e tij V. Kuti, duke zotëruar nga ¼ pjesë secili. Vlera prej 500.000 lekë, është paguar cash nga vëllai.

Siç ka deklaruar dhe në deklaratën e pasurisë, si burim për ndërtimin e shtëpisë kanë shërbyer edhe të ardhurat prej 350.000 lekë të siguruara nga shitja e shtëpisë në fshatin Dramosh, Shkodër, që prindërit ia shitën shtetasit H. K.

Shpenzimet për mobilimin e shtëpisë, sipas përlllogaritjeve të përafërta, rezultojnë të jenë rreth 700.000 lekë. Arredimi i shtëpisë, përfshirë dhe pajisjet elektroshtëpiake, është bërë në mënyrë graduale vit pas vitit, në varësi të të ardhurave dhe kursimeve të krijuara, kryesisht gjatë periudhës 2002 - 2007, por nuk kanë ruajtur faturat e mobilimit për kohën dhe vlerën e blerjes.

32.17 Bashkëlidhur subjekti ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- a. Preventiv i ndërtimit të shtëpisë së banimit në vlerën totale 1.576.476 lekë. Çmimet janë vënë sipas manualit të vitit 1997.
- b. 35 fatura të ndryshme për blerje materiale ndërtimore, për periudhën 1997 — 1998, në vlerën totale 901.880 lekë.
- c. Tabela e materialeve të blera me faturë, për materiale të ndryshme ndërtimore.
- d. Shkresë nga ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Jug, datë 07.02.2023.

- e. Faturë për arkëtim të pagesës së parcelës ndërtimore, Drejtoria e Aluiznit Tiranë Jug, datë 07.02.2023.
- f. Vendim për legalizim nga ASHK, Drejtoria Tirana Jug nr. ****, datë 03.02.2023.
- g. Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.02.2023.
- h. Vërtetim nga Kryeplaku i fshatit Dramosh, Komuna Ana e Malit, Shkodër, i cili deklaron se në praninë e tij shtetasi I. K., i shiti shtetasit H. K., shtëpinë e tij në fshatin Dramosh. Lekët e shtëpisë dhe 500 m² tokë në vlerën 350.000 lekë, ia dorëzoi në prezencën e tij.
- i. Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. kol.***, datë 06.12.2023, me palë deklarues B. Kuti, i cili deklaron se në vitin 1997, kanë shitur shtëpinë në fshatin Dramosh Shkodër dhe janë transferuar në Tiranë, në pronën e disponuar nga vëllai Sami Kuti në rrugën ****.
- j. Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 05.12.2023, me palë deklaruese I. Kuti, i cili deklaron se në vitin 1997, shtëpinë që kishin në fshatin Dramosh Shkodër i'a kanë shitur shtetasit H. Kuti, në vlerën 350.000 lekë. Të ardhurat e siguruar nga kjo shitje ja ka dhuruar djemve të tij për ndërtimin e shtëpisë në rrugën ****, Tiranë.

32.18 Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar, rezulton se:

- ✓ Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacionin justifikues për ndërtimin e banesës së ndodhur në rrugën “*****”, Tiranë, blerë në vitin 1996 nga Ndërmarrja Komunale e Banesave, si dhe për burimin e ndërtimit të saj për periudhën 1997—2002, në vlerën totale 1.576.000 lekë, nga subjekti dhe familjarët e tij.
- ✓ Shpenzimet për mobilimin e kësaj banese janë në vlerën rreth 700.000 lekë për periudhën 2002 — 2007, me burim të ardhurat familjare.

33. Pasuria nr. 2 (e tjetërsuar)

Autoveturë tip BMW 1.9, prodhim i vitit 1993, blerë me kontratë shitblerje të datës 11.01.2009, nr. **rep., nr. ** kol., në vlerën 450.000 lekë.

Burimi i krijimit: kursime nga të ardhurat e familjes.

Zotëron 50 %

Pasuri e tjetërsuar, shitur me kontratë shitje datë 06.03.2014, nr. *** rep., nr. *** kol., në vlerën 220.000 lekë.

33.1Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. ** kol., datë 11.01.2009.
- Kontratë shitblerje automjeti, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 06.03.2014.

HETIMI ADMINSTRATIV

33.2 DPSHTRR me shkresën nr. *** prot., datë 11.08.2023, konfirmon se shtetasi Sami Kuti ka patur të regjistruar mjetin me targë TR*** (me status çregjistruar). Bashkëlidhur dokumentacioni, nga ku rezulton si më poshtë:

33.3 Referuar kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.01.2009, pala shitëse A. M. i ka shitur palës blerëse Sami dhe Vehbije Kuti, automjetin tip BMW, viti i prodhimit 1993, në vlerën 450.000 lekë. Vlera është likuiduar ndërmjet palëve. Bashkëlidhur praktika.

33.4 Nëpërmjet kontratës së shitblerjes së automjeti, nr. ** rep., nr. *** kol., datë 06.03.2014, Sami Kuti i shet palës blerëse R. O., automjetin tip BMW, viti i prodhimit 1993, në vlerën 220.000 lekë. Likuidimi është kryer jashtë zyrës noteriale. Bashkëlidhur praktika.

✓ **Konfirmohet blerja dhe shitja e automjetit të deklaruar me dokumentacionin e dorëzuar dhe përqijjen e DPSHTRR.**

34. **Pasuria nr. 3 (e tjetërsuar)**

Autoveturë tip Mercedes Benz, viti i prodhimit 2005, blerë më 03.05.2016, në bashkëpronësi me vëllain B. Kuti (certifikatë pronësie mjeti *****)

Vlera 2.500 euro.

Zotëron 50%.

Burimi i krijimit: kursime nga të ardhurat e familjes.

E tjetërsuar, dhuruar vëllait B. Kuti, kontratë datë 19.02.2020, nr. *** rep. nr. *** kol.

34.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratën kontratën e dhurimit, datë 19.02.2020.

HETIMI ADMINISTRATIV

34.2 DPSHTRR me shkresën nr. *** prot., datë 11.08.2023, konfirmon se shtetasi Sami Kuti ka patur të regjistruar mjetin me targë AA***. Bashkëlidhur dokumentacioni si më poshtë:

34.3 Deklaratë doganore, datë 03.05.2016, për mjetin tip Mercedes Benz, E220, viti 2005, importues B. K. dhe Sami Kuti, vlera 2.500 euro, dogana 80.763 lekë. Bashkëlidhur praktika.

34.4 Kontratë dhurimi, nr. *** rep., *** kol., datë 19.02.2020, me palë dhuruese Sami Kuti dhe pranues dhurimi B. Kuti, me objekt dhurimin e automjetit tip Mercedes Benz, E220 Cdi, viti 2005, me targë AA***. Bashkëlidhur praktika.

✓ **Konfirmohet blerja dhe dhurimi i automjetit të deklaruar me dokumentacionin e dorëzuar dhe përqijjen e DPSHTRR.**

35. **Pasuri nr. 4**

Llogari bankare për pagat në Raiffeisen Bank, krijuar në Prill 2005, mbyllur më datë 16.05.2018.

Burimi: të ardhura nga paga në Gardën e Republikës, për periudhën Prill 2005 - Mars 2018.

35.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës statement nga Raiffeisen Bank, datë 11.04.2018, për llogari në lekë, në emër të Sami Kuti, për periudhën 06.05.2005 deri më datë 30.03.2018.

HETIMI ADMINISTRATIV

35.2 Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, ka bashkëlidhur CD të llogarive bankare të Sami Kuti, ku konfirmohet llogari page në lekë, për periudhën 2005 - 2018.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank.**

36. Pasuri nr. 5

Llogari bankare për pagat në Credins Bank (krijuar në Mars 2018), me gjendje në datë 08.03.2023, shuma 90.671 lekë.

Burimi, të ardhura nga paga në Gardën e Republikës, Prill 2018 deri aktualisht.

Vlera 90.671 lekë.

Zotëron 100 %.

36.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës statement nga Credins Bank, datë 14.02.2023, për llogari në lekë, në emër të Sami Kuti.

36.2 Credins Bank me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2023, konfirmon në emër të Sami Kuti, llogari page në lekë, për periudhën 04.04.2018 deri më datë 14.02.2023. Gjendja më datë 09.03.2023 rezulton në vlerën 90.671 lekë.

✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e Credins Bank.**

37. Pasuria nr. 6

Depozitë bankare në Credins Bank, krijuar në Shtator 2016, me bashkëshorten Vehbije, tërhequr e gjithë shuma gjatë vitit 2017, mbyllur në Tetor 2020.

Burimi: kursime nga të ardhurat familjare.

Vlera: 1.000.000 lekë. **Zotëron** 50 %.

37.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës kontratë depozitë pa afat, datë 02.09.2016, me palë Credins Bank dhe Sami dhe Vehbije Kuti.

HETIMI ADMINISTRATIV

37.2 Për depozitën bankare në vlerën 1.000.000 lekë, Credins Bank me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2023, konfirmon llogari në lekë, në emër të Sami dhe Vehbije Kutu, ku konstatohet se në datën 02.09.2016, subjekti krediton vlerën 1.000.000 lekë, me përshkrimin “Të ardhura nga kursime familjare”, të cilën e mbyll në depozitë.

37.3 Në lidhje me depozitën e deklaruar si më sipër, subjekti ka dhënë sqarime me shkrim se vlera prej 1.000.000 lekë të depozituar pranë Credins Bank, ka qenë nga kursimet familjare, gjendje cash pas tërheqjes pjesë-pjesë nga llogaritë e tyre rrjedhëse të pagës. Tërheqja e kësaj vlere gjatë vitit 2017, është bërë për të mbuluar shpenzimet e shkollimit të fëmijëve, pasi u kthyen në Tiranë, pas mbarimit të mandatit të bashkëshortes, në Përfaqësinë Ushtarake të Shqipërisë, në NATO.

- ✓ Konstatohet se për periudhën 04.01.2017 deri më datë 18.08.2017, tërheq nga llogaria në total 1.000.976 lekë. Depozita rezulton e mbyllur.
- ✓ Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me burimin e krijimit të kësaj depozite, nga kursimet familjare, si dhe destinacionin e përdorur të saj pas tërheqjes, për shpenzimet e shkollimit të fëmijëve (trajtuar më poshtë).
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përqijqjen e Credins Bank.

38. Pasuria nr. 7

Gjendje cash: 240.000 lekë.

Zotëron 50 %.

- ✓ Të ardhurat mundësojnë gjendjen cash të deklaruar.

39. DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

1) Të ardhura nga puna në funksionin Shef Kazermimi në Gardën e Republikës, për periudhën 10.08.1992 - 01.09.1993, Shef veshmbathje në Gardën e Republikës për periudhën 01.09.1993 - 06.03.2006, Shef sektori në sektorin e mbështetjes me logjistikë, në Gardën e Republikës, për periudhën 06.03.2006 - 01.09.2009, Shef sektori në sektorin e mbështetjes me logjistikë dhe Zv/Kryetar i degës së mbështetjes me logjistikë në Gardën e Republikës, për periudhën 01.09.2009 - 01.07.2012, Kryetar i degës së mbështetjes me logjistikë në Gardën e Republikës, për periudhën 01.07.2012 - 28.01.2014, sipas vërtetimeve të Gardës së Republikës (Gusht 1992 - Prill 2005) dhe nxjerrjes së llogarisë nga Raiffeisen Bank (Prill 2005 - Janar 2014). **Vlera 10.470.897 lekë.**

2) Të ardhura gjatë trajtimit me pagesë kalimtare në Gardën e Republikës, për periudhën 28.01.2014 - 28.01.2016 (periudhë në të cilën shoqëroja bashkëshorten në Bruksel, me detyrë në përfaqësinë ushtarake të Shqipërisë në NATO), sipas nxjerrjes së llogarisë së Raiffeisen Bank (Janar 2014 - Janar 2016). **Vlera 860.190 lekë.**

3) Të ardhura nga puna në funksionin Shef i sektorit të mbështetjes me logjistikë dhe

Zv/Kryetar i degës së mbështetjes me logjistikë, në Gardën e Republikës, për periudhën 16.10.2016 — 05.07.2018, Shef Sektori në sektorin logjistik në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse në Gardën e Republikës, për periudhën 05.07.2018 - 18.09.2020, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse në Gardën e Republikës, për periudhën 18.09.2020 deri aktualisht, sipas nxjerrjes së llogarisë nga Raiffeisen Bank (Tetor 2016 - Mars 2018) dhe Credins Bank (Prill 2018 - Shkurt 2023). **Vlera 6.731.688 lekë.**

4) Të ardhura nga dhënia me qira e bodrumit, për periudhën 31.01.2014 — 31.01.2015, sipas kontratës së qirasë datë 30.01.2014, nr. *** rep., nr. *** kol. **Vlera 120.000 lekë.**

5) Të ardhura nga dhënia me qira e bodrumit, për periudhën 01.02.2015 — 31.07.2016, sipas kontratës së qirasë datë 25.03.2015, nr. *** rep., nr. *** kol. **Vlera 180.000 lekë.**

6) Të ardhura nga dhënia me qira e bodrumit, për periudhën 01.08.2016 — Prill 2019, sipas kontratës së qirasë datë 17.09.2016, nr. *** rep., nr. *** kol. **Vlera 214.500 lekë.**

7) Të ardhura nga dhënia me qira e bodrumit, për periudhën 05.07.2019 — 28.05.2020, sipas kontratës së qirasë datë 05.07.2019, nr. *** rep., nr. *** kol. (revokuar me 28.05.2020, nr. *** rep., nr. *** kol), dhe për periudhën 01.06.2021 — 31.3.2022, sipas kontratës së qirasë datë. 03.06.2021, nr. *** rep., nr. *** kol (zgjidhur me mirëkuptim në datë 31.03.2022). **Vlera 170.000 lekë.**

8) Të ardhura nga shitja e automjetit tip BMW e vitit 1993, sipas kontratës së datës 06.03.2014. Vlera 220.000 lekë.

39.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacion justifikues të nevojshëm për kryerjen e hetimit administrativ.

HETIMI ADMINISTRATIV

39.2 Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, ka Bashkëlidhur CD të llogarive bankare të Sami Kuti, ku konfirmohet llogari page në lekë, me kreditime nga paga, shpërblime, dieta dhe veshje, për periudhën 06.05.2005 - 12.04.2018, në vlerën totale rreth 9.442.000 lekë. Gjithashtu, konfirmon llogari në usd, ku konstatohet se në datën 11.08.2015, krediton vlerën 5.000 usd, vlerë e cila tërhiqet nga llogaria, për periudhën 22.09.2016 - 14.10.2016.

39.3 Credins Bank me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2023, konfirmon llogari në lekë, në emër të Sami Kuti, ku konfirmohen kreditimet nga paga, shpërblime, dieta, nga Garda e Republikës, për periudhën 04.04.2018 - 03.03.2023, në vlerën totale rreth 5.564.000 lekë dhe qira rreth 170.000 lekë.

39.4 ISSH Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën datë 18.08.2023, ka bashkëlidhur vërtetim për vjetërsinë në punë për shtetasin Sami Kuti, periudha e punës 1987- 1988.

39.5 ISSH me shkresën nr. *** prot., datë 11.08.2023, konfirmon pagat neto të Sami Kuti, për periudhën janar 2012 - qershor 2023, nga Garda e Republikës.

39.6 DPT Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 11.12.2023, konfirmon se subjekti J. G., me Nipt L****C, ka paguar tatim mbi qiranë, për periudhën Mars 2015 - Prill 2019, si dhe për subjektin A. Rr., me Nipt K****0, ka paguar tatim mbi qiranë, për periudhën Korrik 2019 - Korrik 2021.

39.7 Në lidhje me pagesat e detyrimeve tatimore për kontratat e dhënies me qira të bodrumit, me inventarin e datës 05.01.2024, subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, se në të gjitha rastet këto pagesa janë bërë nga qiramarrësi, pavarësisht nëse, në kontratat e qirasë ka qenë detyrim i qiradhënësit apo qiramarrësit. Konkretisht, kjo ka gjetur zbatim për kontratën e qirasë të datës 30.01.2014, për periudhën 31.01.2014 deri 31.01.2015 dhe për kontratën e qirasë të datës 25.03.2015, për periudhën 01.02.2015 deri 31.07.2016, ku detyrimet tatimore janë paguar nga qiramarrësi J. G. Gjithashtu, ka gjetur zbatim edhe për kontratën e qirasë të datës 05.07.2019, (revokuar në datë 28.05.2020) për periudhën 05.07.2019 deri 28.05.2020, ku detyrimet tatimore janë paguar nga qiramarrësi A. Rr. Të ardhurat e qirasë me përfaqësi janë ato të deklaruara në deklaratën e pasurisë, duke llogaritur pagesat mujore. Me bankë janë ato të konfirmuara nga Credins Bank dhe pjesa tjetër është bërë cash. Sqaron se vëllai B. K., si bashkëpronar në pasurinë e dhënë me qira, në rastet kur ka firmosur te kontrata e qirasë, nuk ka përfituar të ardhura nga dhënia me qira e kësaj pjese të bodrumit, pasi kjo pjesë e bodrumit administrohet nga ana e tij dhe pjesa tjetër e bodrumit administrohet nga ana e vëllait, sigurisht dhe të mirëkuptimit të dyanshëm. Në lidhje me vlerën prej 5.000 usd, të depozituar në Raiffeisen Bank në Gusht të vitit 2015, sqaron se kanë qenë kursime familjare. Duke qenë jashtë shtetit në atë periudhë i kanë depozituar për efekt sigurie. Destinacioni i përdorimit i tyre, ka qenë për nevoja familjare, kryesisht për shkollimin e fëmijëve.

39.8 Bashkëlidhur subjekti ka dorëzuar dokumentacion, nga ku rezulton si më poshtë:

- Deklaratat tatimore e tatimit të mbajtur në burim, për periudhën Gusht 2019 - Korrik 2020, në emër të A. Rr. Bashkëlidhur kontratë qiraje datë 05.07.2019, si dhe revokim kontrate qiraje datë 28.05.2020.
- Mandat pagesat nga Societe Generale Albania, (gjithsej 21 mandate), për periudhën Korrik 2015 - Prill 2017, ku konfirmohen pagesat e tatimi në burim nga J. G. në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 06.12.2023, me palë deklarues B. Kuti, i cili deklaron se nga dhënia me qira e sipërfaqes së bodrumit prej 30 m² nuk ka përfituar të ardhura, pavarësisht se ka nënshkruar kontratat e qirave për periudhën 2014 - 2021. Të ardhurat e këtyre qirave i ka përfituar vëllai Sami Kuti jo vetëm si pronar fillestar i kësaj pasurie, por edhe për faktin se kjo pjesë e bodrumit administrohet nga familja e tij. Nënshkrimi i kontratave është bërë me mirëkuptim dhe vetëm si akt juridik, si bashkëpronar i pasurisë në të cilën ndodhej bodrumi i dhënë me qira në rrugën ****, Tiranë.

- ✓ Të ardhurat neto të subjektit nga paga, shpërblime, dieta, veshje, taksa e solidaritetit, etj., për periudhën 1992 — Mars 2023, rezultojnë të dokumentuara në vlerën totale rreth 18.192.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat neto nga qiradhënia, për periudhën 2014 - Mars 2022, janë të dokumentuara në vlerën prej 170.000 lekë (me bankë) + 496.000 lekë (sipas kontratave), në vlerën totale të llogaritur prej 666.000 lekë.
- ✓ Subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion në lidhje me pagesat e detyrimeve tatimore për qiratë nga ana e qiramarrësve, për periudhën 2014 — 2022, të konfirmuara edhe nga DPT Tiranë.

DETYRIME FINANCIARE

40 **Kredi bankare në shumën 800.000 lekë**, kontratë nr. ***, datë 23.10.2018, me kohëzgjatje 3 vjet, mbyllur në 23.10.2021. Norma e interesit 6 %, kësti mujor 24.628 lekë. Kredia është shlyer deri në Tetor 2021.

40.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës kontratën e kredisë konsumatore, datë 23.10.2018.

HETIMI ADMINISTRATIV

40.2 Credins Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2023, konfirmon në emër të Sami Kutit, llogari page në lekë, ku konstatohet kredia e disbursuar në datën 23.10.2018, në vlerën 800.000 lekë. Për periudhën 25-26.10.2018, subjekti tërheq nga llogaria në total vlerën 750.000 lekë. Kredia rezulton e mbyllur në vitin 2021.

40.3 I pyetur në lidhje me qëllimin e marrjes së kredisë, me inventarin e datës 05.01.2024, subjekti ka dorëzuar shpjegime me shkrim, ku sqaron se është përdorur për shkollimin e fëmijëve.

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Credins Bank.
- ✓ Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me destinacionin e përdorur të kredisë, për shpenzimet e shkollimit të fëmijëve (trajtuar më poshtë).

41 **Hua në shumën 7.000 usd**, marrë në Korrik 1997, shlyer deri në Qershor 2004.

41.1 Në lidhje me huan e deklaruar, me inventarin e datës 05.01.2024, subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, se duke qenë se në vitin 1997 filluan ndërtimin e shtëpisë së banimit dhe në kushtet e pamundësisë financiare për të përballuar shpenzimet, ka marrë nga i njohuri i tij shtetasi K. J., i cili kishte aktivitet privat, një hua pa interes prej 7.000 Usd, të cilën sipas mundësive i'a ka shlyer tërësisht deri në vitin 2004. Subjekti sqaron se nuk disponon dokumentacion në lidhje me të ardhurat e shtetasit K. J., pasi ka kaluar kohë e gjatë.

- ✓ Subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues në lidhje me huanë e deklaruar, marrë në vitin 1997 dhe shlyer në vitin 2004 dhe rrjedhimisht për të është i aplikueshëm neni 32, pika 1.1 e ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

I. Shpenzime të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur — Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.

42 Subjekti ka deklaruar: shpenzime për ujë 23.205 lekë, drita 50.158 lekë, shërbim celular 32.300 lekë. (Sipas librezave të pagesës së energjisë, ujit, faturave të telefon celular). Vlera **105.663 lekë**.

42.1 Bashkëlidhur deklaratës:

- Libreza nga FSHU (dy libreza), në emër të Sami Kuti, ku konstatohen pagesat për vitin 2022, në vlerën 3.638 leke dhe 45.818 lekë.
- Librezë nga UKT, në emër të Sami Kuti, adresa *****, familjarë, ku konstatohen pagesat për Vitin 2022, në vlerën totale rreth 23.205 lekë.

42.2 FSHU me shkresën nr. *** prot., datë 09.08.2023, konfirmon në emër të Sami Kuti një kontratë furnizimi me energji elektrike, në instancën Tiranë, rruga ****.

42.3 15 Shoqëritë Rajonale të Ujësjetllës Kanalizime, konfirmojnë se subjekti apo personat e lidhur, nuk figurojnë të kenë lidhur kontrata për shërbim furnizimi me ujë të pijshëm, pranë këtyre shoqërive rajonale.

42.4 Vodafone, me shkresën nr. *** prot., datë 15.11.2023, ka bashkëlidhur CD, ku konfirmon në emër të Sami Kuti, numrin 0694****3 (aktiv), si dhe numrin 069****5 (deri më datë 11.03.2022), regjistruar në emër të institucionit Ministria e Brendshme/Garda e Republikës. Pagesat për vitin 2022, për numrin 069****3, rezultojnë në vlerën totale 8.438 lekë dhe për numrin 069****5, në vlerën totale 5.980 lekë. Gjithashtu rezulton se ka pasur të regjistruar numrat 067****5 dhe 068****8. Shtetasja J. Kuti, ka pasur të regjistruar numrin 069****7.

42.5 One Albania, me shkresën nr. *** prot., datë 28.09.2023, konfirmon në emër të Sami Kuti numrin 068****8, ku pagesat për vitin 2022 rezultojnë në vlerën totale 1.500 lekë. Konfirmon në emër të Sejvi Kuti numrin 068****5, ku pagesat për vitin 2022 rezultojnë në vlerën totale 1.800 lekë. Konfirmon në emër të Vehbije Kuti numrin 068****4, aktivizuar në vitin 2023. Bashkëlidhur praktika.

42.6 Tring, me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, nuk konfirmon kontratë të lidhur me subjektin apo personat e lidhur, për periudhën e kërkuar.

42.7 Abissnet, me shkresën nr. V-Prot., datë 14.08.2023, nuk konfirmon kontratë të lidhur me subjektin apo personat e lidhur, për periudhën e kërkuar.

42.8 Digicom, me shkresën nr. *** prot., datë 09.08.2023, nuk konfirmon kontratë të lidhur me subjektin apo personat e lidhur, për shërbime interneti, për periudhën e kërkuar.

42.9 Me inventarin e datës 05.01.2024, subjekti ka dorëzuar sqarime me shkrim, ku sqaron se ka paraqitur dy libreza të energjisë elektrike me FSHU. Njëra librezë është për shtëpinë, ndërsa librezat tjetër i përket bodrumit. Duke qenë se herë pas here, bodrumin e jepte me qira dhe në raste të tilla, çmimi i energjisë ndryshon nga ai që është për familjarë, kanë bërë kontratë të posaçme për bodrumin. Vlera prej 3.638 lekë i përket librezës së bodrumit, duke mos pasur aktivitet, si tarifë e shërbimit që FSHU faturon për çdo kontratë energjie, gjatë periudhës që nuk ka konsum fiktiv.

✓ **Shpenzimet e deklaruara për ujë, drita, telefoni, internet, gjatë periudhës së sipërcituar, me kontrata në emër të subjektit dhe familjarëve, rezultojnë në total rreth 76.000 lekë.**

II. Shpenzime për udhëtime private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara. Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022.

43 Subjekti ka deklaruar si më poshtë:

- Shpenzime udhëtimi Samiu, datë 28.10.2022 - 06.11.2022, qëndrimi te fëmijët në Belgjikë. Vlera 50 euro.
- Shpenzime udhëtimi Samiu, datë 15.03.2022 - 22.03.2022, qëndrimi te fëmijët në Belgjikë. Vlera 60 euro.
- Shpenzime udhëtimi Samiu, datë 28.10.2021 - 01.11.2021, qëndrim te fëmijët në Belgjikë. Vlera 130 euro.
- Shpenzime udhëtimi Samiu, Vehbija dhe Juvena, me makinë, datë 05.10.2021 - 07.10.2021, qëndrimi në hotel (hoteli ishte në Prishtinë, me kursin e lartë të sigurisë dhe mbrojtjes). Vlera 40 euro.
- Shpenzime udhëtimi Samiu, me makinë, në datë 30.10.2020 - 31.10.2020, qëndrim në hotel në Prishtinë. Vlera 20 euro.
- Shpenzime udhëtimi Samiu, me makinë, datë 09.10.2020 - 11.10.2020, qëndrimi në KFOR. Vlera 30 euro.
- Shpenzime udhëtimi Samiu, me makinë, datë 01.08.2020 - 02.08.2020, qëndrimi në hotel në Prishtinë. Vlera 20 euro.
- Shpenzime udhëtimi Samiu, me makinë, datë 12.06.2020 - 14.06.2020, qëndrimi në hotel në Prishtinë. Vlera 40 euro.
- Shpenzime udhëtimi Samiu, me makinë, në datë 06.03.2020 - 08.03.2020, qëndrimi në KFOR. Vlera 30 euro.

- Shpenzime udhëtimi Samiu, me makinë, në datë 25.01.2020 - 27.01.2020, qëndrimi në KFOR. Vlera 30 euro.
- Shpenzime udhëtimi Vehbija, datë 28.10.2022 - 06.11.2022, qëndrim te fëmijët në Belgjikë. Vlera 50 euro.
- Shpenzime udhëtimi Vehbija, kthimi në datë 22.03.2022, qëndrim te fëmijët në Belgjikë; në vajtje biletën Tiranë - Zagreb - Eindhoven, i'a preu puna, pasi në 15-18 Mars ishte një takim pune në Zagreb. Vlera 82 euro.
- Shpenzime udhëtimi vajza Juvena, Bruksel, datë 28.01.2022 - 04.02.2022. Vlera 110 euro.
- Shpenzime udhëtimi vajza Juvena, Bruksel, datë 04.10.2021 - 17.10.2021. Vlera 167 euro.
- Shpenzime udhëtimi djali Sejvi, Bruksel, datë 24.06.2022 - 17.07.2022. Vlera 235 euro.
- Shpenzime udhëtimi djali Sejvi, Bruksel, datë 12.05.2022 - 15.05.2022. Vlera 200 euro.
- Shpenzime udhëtimi djali Sejvi, Bruksel, datë 28.01.2022 - 13.02.2022. Vlera 110 euro.
- Shpenzime udhëtimi djali Sejvi, Bruksel, datë 12.07.2021 - 03.08.2021. Vlera 235 euro.
- Shpenzime udhëtimi djali Sejvi, Bruksel, datë 24.01.2021 - 12.02.2021. Vlera 160 euro.

43.1 Me inventarin e datës 05.01.2024 subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, ku sqaron se nuk disponon dokumentacion mbi shpenzimet e deklaruar, por për këtë është referuar shënimeve të tij mbi këto udhëtime, të cilat siç duken edhe në deklaram, kryesisht janë udhëtime low-cost ose udhëtime me makinë për Prishtinë, gjatë kohës kur bashkëshortja ishte me mision në KFOR. Në lidhje me daljen në pikën kufitare Morinë në datë 30.10.2020, sqaroi se është kthyer në datë 31.10.2020, siç e ka deklaruar, por nuk do të jetë regjistruar nga kjo pikë kufitare, për shkak të ngarkesave të kalimit të mjeteve në këtë pikë doganore.

43.2 Në lidhje me qëndrimin e tij dhe të familjarëve në Bruksel, sqaron se gjatë periudhës së qëndrimit të atyre atje, të gjitha shpenzimet janë mbuluar nga Përfaqësia Ushtarake e Shqipërisë në NATO, që përfshijnë qira banese, ujë, energji elektrike, telefoni, etj., pa përfshirë shpenzimet për ushqimin. Për periudhën Korrik 2013 - Korrik 2016, aq sa ishte edhe mandati i bashkëshortes, në Përfaqësinë Ushtarake të Shqipërisë, në NATO, shpenzimet mesatare mujore për ushqim apo shpenzime të ndryshme mund të kenë qenë afërsisht 600 euro në muaj në total, pasi duke pasur ekonomi familjare, shpenzimet e tyre nuk shkonin më shumë se kjo vlerë.

43.3 Bashkëlidhur subjekti ka dorëzuar printimet nga sistemi Tims, ku evidentohen hyrje-daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë për shtetasit; Sami, Vehbije, Juvena dhe Sejvi Kuti.

- ✓ **Shpenzimet e deklaruar për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur gjatë periudhës së sipërcituar, rezultojnë në total rreth 1.800 euro, konvertuar rreth 206.000 lekë.**
- ✓ **Shpenzimet familjare për jetesë (pa përfshirë qira banese, ujë, energji elektrike, telefon) në Bruksel, për periudhën Korrik 2013 — Korrik 2016, llogariten në total rreth 22.000 euro (vlera 600 euro/muaj), konvertuar rreth 2.500.000 lekë.**

III. Shpenzime për arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

44 Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në formular si më poshtë vijon:

44.1 Pagesë tarifa vjetore për studimet e larta të vajzës Juvena, në shkollën publike Odisee K.U.Leuven, Bruksel, sipas tarifave të këtij institucioni në vitin akademik dhe **vlera totale 5.424 euro.**

- 2013 — 2014, shuma 610 euro;
- 2014 — 2015, shuma 619 euro;
- 2015 — 2016, shuma 736 euro;
- 2016 — 2017, shuma 802 euro;
- 2017 — 2018, shuma 906 euro;
- 2018 — 2019, bridging program shuma 1.750 euro.

44.2 Pagesë tarifa vjetore për studimet e larta të djalit Sejvi, në shkollën publike ULB (Universiteti i Lirë i Brukselit), sipas tarifave të këtij institucioni në vitin akademik 2016 - 2017, 2017 - 2018, 2018 - 2019, 2019 - 2020, 2020 - 2021, 2021 - 2022, dhe 2022 - 2023, nga 835 euro viti. **Vlera 5.845 euro.**

44.3 Pagesë për qira dhome, kontratë qiraje, për djalin Sejvi. Vlera 3.760 euro. Bashkëlidhur deklaratës:

- Marrëveshje për akomodim studenti (në Gjuhën Angleze), në Bruksel, datë 17.08.2021, për dhënie ambienti me qira, për periudhën 01.09.2021 — 31.08.2022, në vlerën totale 3.720 euro ose 310 euro/muaj dhe disa pagesa ekstra.
- Marrëveshje për akomodim studenti (në Gjuhën Frënge), në Bruksel, datë 18.08.2022, për vitin akademik 2022 — 2023, në vlerën totale 3.840 euro ose 320 euro/muaj, (llogaritur 7 muaj në vlerën 2.240 euro).
- Dy fatura (në gjuhën Angleze), nga K.U. Leven, që vërtetojnë se Juvena Kuti, është regjistruar si student, për çdo vit akademik (2013 – 2015) dhe ka kryer pagesat në vlerën 610 euro dhe 619 euro.
- Katër faturë (në gjuhën Angleze), nga Odisee University College, për studenten Juvena Kuti, për pagesën e tarifës së shkollimit, në vlerat: 736 euro, 802 euro, 906 euro dhe 1.750 euro, periudha 2015 – 2018.
- Tarifat e regjistrimit (në gjuhën Angleze), nga ULB (Universiteti i Lirë i Brukselit), për studentin Sejvi Kuti, për çdo vit akademik, periudha 2016 — 2023, në vlerën 835 euro/vit akademik.

44.4 Me inventarin e datës 05.01.2024 subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues si dhe sqarime me shkrim, për shpenzimet e deklaruara, si më poshtë:

- Shpenzimet e deklaruara për pagesë qira dhome për djalin Sejvi, në vlerën 3.760 euro, i përkasin vitit 2022, ndërkohë kontratat e qirasë së dhomës janë për vite akademike dhe jo për vite kalendarike, prandaj janë dy kontrata që i përkasin dy viteve të ndryshme akademike. Duke qenë se çmimi i qirasë së dhomës ka ndryshuar me 10 euro, ka paraqitur dy kontrata qiraje. Pra shpenzimet vjetore 2022 për qira dhome janë llogaritur: 8 muaj (1 Janar 2022 - 31 Gusht 2022) x 310 euro/muaj (sipas kontratës 2021 - 2022) + 4 muaj (1 Gusht 2022 - 31 Dhjetor 2022) x 320 euro/muaj (sipas kontratës 2022 - 2023) 3.760 euro (2.480 euro + 1.280 euro).
- Shpenzimet totale për qira e shkollim të vajzës e djalit, jashtë vendit, përllogariten:
- Për shkollim: për periudhën Shtator 2013 - Qershor 2019, pagesë për shkollën e lartë të vajzës në Bruksel dhe për periudhën Shtator 2016 - Shkurt 2023, pagesë për shkollën e lartë të djalit në Bruksel. Shkollën e mesme djali e mbaroi 2013 - 2016, në shkollë shtetërore, pa asnjë tarifë shkolle.
- Vajza: Pagesë tarifa vjetore për studimet e larta në shkollën publike Odisee K. U. Leuven, Bruksel, sipas tarifave të këtij institucioni në shumën totale 5.424 Euro.
- Djali: Pagesë tarifa vjetore për studimet e larta në shkollën publike ULB (Universiteti i Lirë i Brukselit), sipas tarifave të këtij institucioni, në shumën 835 euro/viti dhe shuma totale 5.845 Euro.
- Për qira: Gjatë periudhës 2013 - 2016, si familje kanë jetuar në Bruksel, pasi bashkëshortja ishte emëruar në Përfaqësinë Ushtarake të Shqipërisë në NATO dhe shpenzimet (qira shtëpie, etj.) mbuloheshin nga përfaqësia. Pagesa e qirasë për dhomat e fëmijëve si student, filloi pasi mbaroi mandati tre vjeçar në NATO, ku bashkëshortja dhe subjekti u kthyen në vendet e punës në Tiranë, ndërsa vajza do vijonte studimet e larta dhe djali do i fillonte ato në Shtator 2016. Qiraja e dhomës së vajzës për periudhën Shtator 2016 - Shtator 2019 ka qenë rreth 9.960 euro, më pas ajo është punësuar dhe ka bashkëjetuar. Qiraja e dhomës së djalit për periudhën shtator 2016 - Shkurt 2023 ka qenë rreth 22.200 euro.
- Totali i shpenzimeve të fëmijëve, për qira e shkollim, janë në total rreth 43.430 euro.

44.5 Subjekti sqaron, se pas përfundimit të mandatit të bashkëshortes në Përfaqësinë Ushtarake të Shqipërisë në NATO, fëmijët kanë qëndruar atje, ku kanë vazhduar shkollimin e tyre. Shpenzimet mesatare mujore për secilin prej fëmijëve, për ushqim apo shpenzime të ndryshme (pa përfshirë qiranë the pagesën e shkollimit), kanë qenë afërsisht 250 euro në muaj, pasi gjatë periudhës së shkollimit, studionin kishte një mensë të përbashkët, me çmime të arsyeshme për studentët. Thekson se vajza nga fundi i vitit 2019 ka filluar të bashkëjetojë dhe ka kaluar në shtëpi më vete, së bashku me bashkëjetuesin e saj, të dy në marrëdhënie pune, ndërsa djali Sejvi vazhdon studimet në Bruksel.

44.6 Bashkëlidhur subjekti ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë qiraje për banesë studenti (në gjuhën Frënge), në Bruksel, datë 31.08.2016, viti akademik 2016 — 2017, me qiradhënës P. F., qiramarrës Sejvi Kuti, vlera 2.940 euro, ose 240 euro/muaj.
 - Marrëveshjet për akomodim studenti (në Gjuhën Angleze), në Bruksel, për vitet akademike 2017 — 2018, 2018 — 2019, 2019 — 2020 dhe 2020 — 2021, me palë qiradhënës P. F. dhe qiramarrës Sejvi Kuti, për dhënie ambienti me qira, duke përcaktuar pagesën mujore.
 - Marrëveshjet për akomodim studenti (në Gjuhën Angleze), në Bruksel, për vitet akademike 2016 — 2017, 2017 — 2018 dhe 2018 — 2019, me palë qiradhënës P. F. dhe qiramarrës Juvena Kuti, për dhënie ambienti me qira, duke përcaktuar pagesën mujore dhe vlerën totale.
 - Thekson se vajza nga fundi i vitit 2019 ka filluar të bashkëjetojë dhe ka kaluar në shtëpi më vete, së bashku me bashkëjetuesin e saj, të dy në marrëdhënie pune, ndërsa djali Sejvi vazhdon studimet në Bruksel.
- ✓ **Shpenzimet e dokumentuara për qira banese dhe arsimimin e fëmijëve qjatë periudhës deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, rezultojnë në vlerën totale rreth 43.500 euro, konvertuar rreth 4.976.000 lekë.**
- ✓ **Shpenzimet për jetesë (pa përfshirë qira banese dhe pagesën e shkollimit), në Bruksel për djalin Sejvi Kuti, periudha Shtator 2016 — Mars 2023, llogariten rreth 19.500 euro, për vajzën Juvena Kuti, periudha Shtator 2016 — Shtator 2019, llogariten rreth 9.250 euro, në total rreth 28.750 Euro (vlera 250 euro/muaj/secili), konvertuar rreth 3.289.000 lekë.**

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES – VEHBIFE KUTI

DEKLARIMI I PASURIVE

45 **Pasuria nr. 1**

Bashkëpronare e pasurisë së paluajtshme, në Njësinë Administrative nr. 5, rruga “*****”, Tiranë, zk. ***, nr. ****, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 500 m², sipërfaqja e ndërtimit 174.2 m², sipërfaqja totale e ndërtimit për banim 198.9 m², për aktivitet 88.1 m², përfutur me vendim legalizimi nr. ****, datë 03.02.2023.

Burimi i krijimit, daton me privatizimin nga Komunale Banesa nr. 2, Tiranë, me kontratë shitje, datë 06.08.1996, nr. *** rep., nr. *** kol., hipotekë nr. ****, datë 06.08.1996, për sipërfaqe truall 212 m², nga e cila ndërtesë 70 m² (në bashkëpronësi të Sami dhe Vehbije Kuti, nga ½ pjesë secili). Me kontratë shitblerje, datë 21.12.2004, nr. **** rep., nr. *** kol., hipotekë datë 30.12.2004, bëhen bashkëpronarë edhe vëllai B. Kuti dhe bashkëshortja e tij V. Kuti, duke zotëruar në këtë mënyrë ¼ pjesë secili (certifikatë për vërtetim pronësie nr. *****, datë 15.05.2014, nga ZVRPP Tiranë, për pasurinë nr. ****, zk. ***, rruga ****, Tiranë), pasi në vitin 1997 prindërit dhe familja e vëllait të bashkëshortit, shitën shtëpinë në fshatin Dramosh, Shkodër, u transferuan në Tiranë dhe në pronën e mësipërme u ndërtua shtëpi banimi dhe bodrum, për të cilën u investua në vite. E gjithë punësoria për shtëpinë është bërë nga prindërit, dhe familja e vëllait të bashkëshortit dhe me ndihmën tonë, të

afërmve e të njohurve tanë. Objekti është deklaruar për legalizim me vetë-deklarim nr. ***, datë 21.08.2006, është aplikuar dhe legalizuar në vitin 2023, me vendimin nr. ****, datë 03.02.2023.

Vlera e privatizimit: 27.935 lekë. Vlera e preventivuar 1.576.476 lekë.

Zotëron: 25%.

✓ **Trajtuar më lart.**

46 **Pasuria nr. 2**

Autoveturë tip Seat Leon, viti i prodhimit 2000.

Burimi, blerë më 09.12.2013, me kursime nga të ardhurat e familjes, e tjetërsuar (shitur me kontratë shitje të datës 29.01.2016, nr. *** rep., nr. *** kol.

Vlera: 2.600 euro.

Zotëron: 100 %.

46.1 **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Faturë shitje (në gjuhën Angleze), nga Grand Quarter General, Belgjikë, datë 09.12.2013, me shitës D. R. P., dhe blerës Vehbije Kuti, për automjet tip Seat Leon, viti 2000, në vlerën 2.600 euro.
- Kontratë shitje automjeti, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.01.2016, me palë shitëse Vehbije Kuti dhe blerës K. Q., për automjet tip Seat Leon, viti 2000, në vlerën 2.800 euro.

46.2 **DPSHTRR** me shkresën nr. *** prot., datë 11.08.2023, nuk konfirmon blerjen dhe shitjen e automjetit të deklaruar nga bashkëshortja si më sipër.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.**

47 **Pasuria nr. 3**

Autoveturë tip Audi A4, viti i prodhimit 2002. Certifikatë pronësie mjeti ****, faturë blerje datë 27.10.2015.

Burimi, kursime nga të ardhurat familjare.

Vlera 3.900 euro.

Zotëron 100 %.

47.1 Bashkëlidhur deklaratës faturë shitje (në gjuhën Angleze), datë 27.10.2015, me shitës B. K. dhe blerës Sami dhe Vehbije Kuti, për automjet tip Audi A4, viti 2002, në vlerën 3.900 euro. Bashkëlidhur certifikata e pronësisë së mjetit, me pronar Vehbije Kuti.

47.2 **DPSHTRR** me shkresën nr. ** prot., datë 11.08.2023, konfirmon të regjistruar në emër të Vehbije Kuli, mjetin me targë AA****. Bashkëlidhur dokumentacioni si më poshtë:

- Deklaratë doganore, datë 11.08.2016, me importues Vehbije Kuti, për automjetin tip Audi, viti 2002, baza e taksueshme 240.854 lekë, doganë 51.165 lekë.
- Leje qarkullimi për automjetin me targë AA ****N, tip Audi, në emër të Vehbije Kuti.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.**

48 **Pasuria nr.4**

Llogari bankare për pagat në Raiffeisen Bank, krijuar në maj 2005, mbyllur në Gusht 2009.

Burimi: të ardhura nga puna si Oficere në FA.

Zotëron 100 %.

48.1 Bashkëlidhur deklaratës:

- Statement nga Raiffeisen Bank, datë 4.10.2018, për llogari në lekë, në emër të Vehbije Kuti, për periudhën 04.05.2005 deri më datë 24.08.2009.

48.2 Raiffeisen Bank me e-mailin e datës 20.11.2023, konfirmon në emër të Vehbije Kuti, llogari page në lekë, për periudhën 2005 — 2009.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank.**

49 **Pasuria nr. 5**

Llogari bankare për pagat në Credins Bank, gjendje në datë 08.03.2023.

Vlera 101.184 lekë.

Burimi, të ardhura nga puna si Oficere në Forcat e Armatosura.

Zotëron 100 %.

49.1 Bashkëlidhur deklaratës:

- Statement nga Credins Bank, datë 14.02.2023, për llogari në lekë, në emër të Vehbije Kuti, për periudhën 04.04.2018 deri më datë 14.02.2023.

49.2 Credins Bank me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2023, konfirmon në emër të Vehbije Kuti, llogari page në lekë, me gjendje në datë 09.03.2023, në vlerën 101.184 lekë.

✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e Credins Bank.**

50 **Pasuria nr. 6**

Llogari bankare në ING Bank, krijuar në 2013, mbyllur në 2018.

Burimi të ardhura nga puna si Oficere Shtabi në Përfaqësinë Ushtarake të Shqipërisë në NATO, në Bruksel, dhe kursime familjare.

50.1 Me inventarin e datës 05.01.2024, subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues si dhe sqarime me shkrim, për llogarinë e mësipërme, ku sqaron se për periudhën 16.07.2013 deri 16.07.2016, bashkëshortja ka qenë me detyrë në Përfaqësinë Ushtarake të Shqipërisë në NATO, Bruksel, Belgjikë. Për këtë arsye, veprimet bankare të kalimit të rrogës, etj., domosdoshmërisht duhet të bëheshin nëpërmjet një banke në Belgjikë. Në këtë mënyrë u bë hapja e llogarisë pranë ING Bank, në Belgjikë. Llogaria është mbyllur në Shtator 2018.

50.2 Bashkëlidhur subjekti ka dorëzuar dokumentacion nga ING Bank, datë 01.12.2023, ku konfirmon se Vehbiye Kutu ka pasur llogari në euro dhe llogari kursimi në euro, të cilat janë çelur në datën 06.08.2013 dhe mbyllur në datën 14.09.2018.

✓ **Subjekti ka dhënë sqarime, si dhe ka dorëzuar dokumentacion justifikues në lidhje me llogarinë e bashkëshortes, pranë ING Bank.**

51 **Pasuri nr. 7**

Llogari bankare në American Bank, hapur dhe mbyllur në vitin 2006 (për rimbursim shëndetësor ndaj meje, nga institucioni ku ndoqa kursin e kualifikimit në SHBA, në vitin 2006).

51.1 Intesa Sanpaolo Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 11.08.2023, konfirmon në emër të Vehbiye Kutu, llogari në usd, për periudhën 08.09.2006 - 02.10.2006, ku konstatohet një kreditim në datën 08.09.2006, në vlerën 198 Usd. Llogaria rezulton e mbyllur.

51.2 Me inventarin e datës 05.01.2024, subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues si dhe sqarime me shkrim, për llogarinë e mësipërme, ku sqaron se për periudhën Tetor 2005 deri Prill 2006, bashkëshortja ka ndjekur kursin e gjuhës dhe Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes (FDMC), në Texas dhe Monterey në USA. Gjatë periudhës së kursit në Monterey, për probleme shëndetësore është trajtuar me mjekim, i cili fillimisht është paguar nga ana e saj dhe më vonë kjo vlerë është rimbursuar nga shkolla, gjë e cila ka diktuar hapjen e një llogarie pranë American Bank. Pra, kjo llogari është hapur vetëm sa për të mundësuar transaksionin e mësipërm dhe me kalimin e vlerës së rimbursimit prej 198 usd, është bërë mbyllja e llogarisë.

✓ **Konfirmohet deklarimi me sqarimet e dhëna, dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ISP Bank.**

52 **Pasuri nr. 8**

Bono thesari 12 muaj, datë 30.01.2023, data emetimit 02.02.2023, maturimi 01.02.2024. Kontratë kujdestarie për titujt e qeverisë, kontratë brokerimi në transaksionet me tituj. **Vlera** 500.000 lekë.

52.1 Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë kujdestarie për titujt e qeverisë, datë 30.01.2023, me palë kujdestar/shoqëria brokerimit Credins Bank dhe klienti Vehbije Kuti. Bonot e thesarit dhe obligacionet shtetërore janë të emetuara nga Qeveria Shqiptare, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Bashkëlidhur praktika.
- Urdhër (Porosi), nga Credins Bank, datë 30.01.2023, me klient Vehbije Kuti, për bono thesari 12 muaj, datë emetimi 02.02.2023, maturimi 01.02.2024, në vlerën 500.000 lekë.
- Mandat akkrëtimi nga Credins Bank, datë 30.01.2023, ku rezulton se Sami Kuti kalon në llogari të bashkëshortes Vehbije Kuti, vlerën 250.000 lekë.

52.2 Credins Bank me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2023, konfirmon llogari në lekë, në emër të Vehbije Kuti, ku konstatohet se në datën 30.01.2023, transferohet vlera 250.000 lekë, nga llogaria e Sami Kuti dhe në datën 02.02.2023, transferohet për “blerje bono”, vlera 481.357 lekë.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përqijjen e Credins Bank.**

53 **Pasuria nr. 9**

Gjendje cash jashtë sistemit bankar.

✓ **Trajtuar më lart.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

1) Të ardhura nga puna në funksionin Shefe finance, në fakultetin e forcave tokësore, Tiranë, për periudhën 01.04.1993 — 16.12.1998, Shefe finance e reparteve autonome në divizionin 8, Tiranë, për periudhën 16.12.1998 — 30.09.2000, specialiste buxheti në komandën e forcës tokësore, Tiranë, për periudhën 01.10.2000 — 01.04.2004, specialiste për investimet në drejtorinë logjistike në shtabin e përgjithshëm të Forcave të Armatosura, për periudhën 01.04.2004 — 17.09.2004, specialiste analize dhe programimi në drejtorinë e menaxhimit të burimeve të mbrojtjes në shtabin e përgjithshëm të FA, për periudhën 17.09.2004 — 01.12.2009, Shefe e sektorit të planifikimit, menaxhimit të burimeve të mbrojtjes në shtabin e përgjithshëm të Forcave të Armatosura, për periudhën 01.12.2009 - 01.06.2010, Shefe sektorit të planifikimit dhe buxhetimit të operacioneve dhe emergjencave, në drejtorinë e programimit të burimeve të mbrojtjes, në shtabin e përgjithshëm të Forcave të Armatosura, për periudhën 01.06.2010 — 15.07.2013, sipas vërtetimit nr. *** datë 11.04.2018, të Qendrës së Personel Rekrutimit pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe nxjerrjes së llogarisë nga Raiffeisen Bank dhe Credins Bank. **Vlera 7.525.336 lekë.**

2) Të ardhura nga puna në funksionin Oficere Shtabi, në përfaqësinë ushtarake të Shqipërisë në NATO, për periudhën 16.07.2013 - 15.07.2016, sipas listë-pagesave standarde të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në Ministrinë e Mbrojtjes. **Vlera 47.691 euro ose 6.598.991 lekë.**

- 3) Të ardhura nga puna në funksionin Shefe Sektori në Qendrën e Manaxhimit të Materialeve të Forcave të Armatosura, për periudhën 16.07.2016 - 01.11.2016, Përgjegjëse sektori programimi dhe analize dhe Zv/Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Monitorimit të Mbrojtjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, për periudhën 01.11.2016 - 04.11.2019, sipas nxjerrjes së llogarisë nga Credins Bank. **Vlera 3.351.604 lekë.**
- 4) Të ardhura nga puna në misionin KFOR, Prishtinë, për periudhën 04.11.2019 - 24.11.2020, sipas nxjerrjes së llogarisë nga Credins Bank. **Vlera 3.292.140 lekë.**
- 5) Të ardhura nga paga si Përgjegjës Sektori Programimi dhe Analize dhe Zv/Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Monitorimit të Mbrojtjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, për periudhën 25.11.2020 deri aktualisht, sipas nxjerrjes së llogarisë në Credins Bank. **Vlera 2.621.874 lekë.**
- 6) Të ardhura nga kursi i kualifikimit në Hungari, për periudhën 07.01.2004 - 06.04.2004. Vlera 670 Usd.
- 7) Të ardhura nga kursi i kualifikimit në Amerikë, për periudhën 31.10.2005 - 19.04.2006. Vlera 7.100 Usd.
- 8) Të ardhura nga kursi i kualifikimit në Amerikë, për periudhën 15.10.2011 - 28.10.2011. Vlera 930 Usd.
- 9) Të ardhura nga programi “Peace with Women Fellowship”, në kuadër të forumit ndërkombëtar të sigurisë Halifax (Kanada-Amerikë), për periudhën Tetor - Nëntor 2018. Vlera 1.000 Usd.
- 10) Të ardhura nga shitja e autoveturës tip Seat Leon, në datë 29.01.2016. Vlera 2.800 euro.

54 Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetime për bazën e vlerësueshme, nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, (4 vërtetime), datë 11.04.2018, me anën e të cilave konfirmohen pagat neto të Vebbiye Kutit, për periudhën 1993 — Dhjetor 2004, në vlerën totale rreth 2.088.000 lekë.
- Statement nga Raiffeisen Bank, datë 04.10.2018, për llogari në lekë, në emër të Vebbiye Kutit, për periudhën 04.05.2005 deri më datë 24.08.2009.
- Statement nga Credins Bank, datë 06.04.2018, për llogari në lekë, në emër të Vebbiye Kutit, për periudhën 01.07.2009 deri më datë 04.04.2018.
- Listë pagesa standarde, nga Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar, për shtetasen Vebbiye Kutit, me detyrë përfaqësuese në Bruksel, ku konfirmohen pagat neto të përfituara për periudhën, korrik 2013 - qershor 2016, në vlerën totale 47.691 euro.
- Statement nga Credins Bank, datë 14.02.2023, për llogari në lekë, në emër të Vebbiye Kutit, për periudhën 04.04.2018 deri më datë 14.02.2023.

54.1 Raiffeisen Bank, me e-mailin e datës 20.11.2023, konfirmon në emër të Vebbiye Kutit, llogari page në lekë, për periudhën 2005 - 2009. Konstatohen kreditimet nga paga dhe shpërblime, në vlerën totale rreth 2.250.000 lekë.

54.2 Credins Bank me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2023, konfirmon llogari në lekë, në emër të Vebbiye Kutit, ku konfirmohen kreditimet nga paga, shpërblime, dieta dhe misione

dhe konferenca, nga Ministria e Mbrojtjes dhe Reparti Ushtarak, për periudhën 01.07.2009 dhe 01.08.2016 - 07.03.2023, në vlerën totale rreth 12.523.000 lekë.

54.3 ISSH, me shkresën nr. *** prot., datë 11.08.2023, konfirmon pagat neto të Vehbije Kutit, për periudhën Janar 2012 - Qershor 2023, nga Ministria e Mbrojtjes dhe Reparti Ushtarak.

54.4 Me inventarin e datës 05.01.2024, subjekti dha sqarime të hollësishme me shkrim në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes, duke dorëzuar dokumentacion justifikues, si më poshtë:

54.5 Urdhër i Ministrit të Mbrojtjes nr. ***, datë 08.12.2003, “Për dërgim jashtë shtetit”, ku është urdhëruar Kapiten Vebije Sala, të shkojë në Budapest, Hungari, për të ndjekur kursin e gjuhës angleze në periudhën 11.01 — 08.04.2004. Shpenzimet mbulohen nga Drejtoria e Administratës dhe Shërbimeve.

54.6 Urdhër i Ministrit të Mbrojtjes nr. ***, datë 18.10.2005, “Për dërgim jashtë shtetit”, ku është urdhëruar Majore Vehbije Kutit, të ndjekë kursin e Manaxhimit të Mbrojtjes, që do të zhvillohet në SHBA, në periudhën 26.10.2005 - 19.04.2006. Shpenzimet mbulohen nga Drejtoria e Administratës dhe Shërbimeve.

54.7 Urdhër i Ministrit të Mbrojtjes, nr. ***, dalë 19.09.2011, “Për dërgim me studime jashtë shtetit”, ku është urdhëruar ndër të tjerë N/Kolonel Vehbije Kutit, të ndjekin kursin e Menaxhimit të Blerjeve të Mbrojtjes, që do të zhvillohet në periudhën 28.10.2011, në SHBA.

54.8 Urdhër i Ministrit të Mbrojtjes, nr. *** datë 09.07.2018, “Për dërgim jashtë shtetit për ndjekje kursi”, ku është urdhëruar Kolonel Vehbije Kutit, të ndjekë programin e lidërsipit Halifax peace With Women Fellowship, që do të zhvillohet në periudhën 24 Tetor - 18 Nëntor 2018, në SHBA dhe Kanada. Shpenzimet do të përballohen nga pala pritëse.

54.9 E-mail, datë 30.11.2023, dërguar nga A. S., (Education and Training Program Manager Office of Defense Cooperation, Unitet States Embassy, Tiranë), drejtuar Vehbije Kutit, ku bën me dije se ka marrë pjesë dhe është trajtuar sipas politikave të secilës shkollë, në kurset si vijon:

- DLI Texas, periudha 26.10.2005 - 03.02.2006;
- IDMC, Montrey, periudha 03.02.2006 - 19.04.2006;
- Principles of Def. Acquisitions Management Course, periudha 15.10.2011 - 28.10.2011.

54.10 E-mail, (në gjuhën Angleze), datë 05.06.2018, nga P. M., që konfirmon se Kolonel Vehbije Kutit, është pranuar të marrë pjesë në Halifax Peace With Women Fellowship. Duke qenë se Ushtria Shqiptare nuk mund të paguajë 25.000 Usd pagesë programi, heq dorë nga kjo tarifë. Prandaj të gjitha shpenzimet si fluturimi, akomodimi, ngrënia etj., nuk do të paguhën nga ushtria Shqiptare.

54.11 Certifikatë (në gjuhën Angleze), datë 07.04.2004, nga Institute for Foreign Language Studies, Budapest Hungary, që vërteton se Vehbiye Kutu, ka përfunduar kursin për periudhën 12 Janar - 7 Prill 2004.

54.12 Nxjerrje llogarie nga ING Bank (në gjuhën Angleze), datë 04.10.2018, për llogari në emër të Vehbiye Kutu, për periudhën 22.03.2018 - 05.04.2018. Konfirmohet kreditimi i vlerës 489 euro.

✓ **Të ardhurat neto të bashkëshortes, për periudhën 1993 — Mars 2023, nga paqa dhe shpërblime, brenda dhe jashtë vendit rezultojnë të dokumentuara në vlerën totale 16.861.000 lekë + 47.691 euro konvertuar rreth 22.317.000 lekë.**

✓ **Të ardhurat e bashkëshortes, nga dietat ditore në Budapest Hungari, për periudhën Janar - Prill 2004, janë në total 670 usd dhe nga dieta ditore në USA, për periudhën Tetor 2005 - Prill 2006, Tetor 2011 dhe Tetor - Nëntor 2018, janë në total rreth 9.100 euro konvertuar rreth 1.113.000 lekë.**

DETYRIME FINANCIARE

55 **Kartë krediti në ING Bank**, e hapur në vitin 2013, mbyllur në vitin 2018.

55.1 Me inventarin e datës 05.01.2024, subjekti ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

55.2 Nxjerrje llogarie nga ING Bank (në gjuhën Angleze), datë 04.10.2018, për llogari kartë krediti në emër të Vehbiye Kutu, për periudhën deri në datë 05.04.2018.

55.3 Subjekti ka paraqitur dokumentacion në lidhje me llogarinë e kartës së kreditit, si më sipër.

56 **Kartë krediti në BKT**, e hapur në vitin 2013, mbyllur në vitin 2017.

56.1 BKT me shkresën nr. ** prot., datë 14.08.2023, nuk konfirmon llogari bankare në emër të subjektit apo personave të lidhur.

56.2 Me inventarin e datës 05.01.2024, subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, në lidhje me kartën e kreditit, ku sqaron se në vitin 2013, bashkëshortja ka hapur kartë krediti pranë BKT, e cila është mbyllur në Nëntor 2017.

56.3 Bashkëlidhur subjekti ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Nxjerrje llogari bankare nga BKT, datë 20.4.2018, për llogari kartë krediti në lekë, në emër të Vehbiye Kutu, për periudhën 21 - 22.11.2017. Bashkëlidhur praktika.

✓ **Konfirmohet deklarimi me sqarimet dhe dokumentacionin e dorëzuar në lidhje me llogarinë e kartës së kreditit pranë BKT.**

57 **Kartë krediti në Credins Bank**, e hapur në vitin 2018.

57.1 Credins Bank konfirmon në emër të Vehbije Kuti, llogari kartë krediti çelur në vitin 2018, me gjendje në datë 09.03.2023, në vlerën 0 lekë.

✓ **Konfirmohet deklarimi me përqijqjen e Credins Bank.**

DEKLARIMI I VAJZËS – JUVENA KUTI

DEKLARIMI I PASURIVE

Pasuria nr. 1

58 Llogari bankare në ING Bank, krijuar në Gusht 2013, me gjendje në datë 20.02.2023, shuma 22.67 euro, në llogari rrjedhëse dhe 30 euro në llogari kursimi.

Burimi, të ardhura nga puna ime si studente, kursime nga të ardhurat familjare dhe kursime nga puna ime me kohë të plotë.

Zotëron 100 %

58.1 Subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, ku sqaron se vlera prej 22.67 euro, gjendje në datë 20.02.2023, në llogarinë rrjedhëse të vajzës, pranë ING Bank, në dokumentin bashkëlidhur, nuk tregohet ekzaktësisht gjendja në datë 20.02.2023, siç kërkohet, pasi nuk ka pasur lëvizje në atë datë, por tregon gjendjen në datë 19.02.2023, në vlerën 22.67 euro. Për gjendjen në llogarinë e kursimeve, po ashtu, nuk tregon gjendjen ekzaktësisht në datë 20.02.2023, por tregon lëvizjet që janë bërë nga muaji janar deri në mars 2023. Në dokumentin e bankës bashkëlidhur, gjendja në datë 12.01.2023 ka qenë 30.02 euro. Bashkëlidhur subjekti ka dorëzuar nxjerrje llogarie nga ING Bank për llogari kursimi në euro, në emër të Juvena Kuti, me balancë në datë 19.02.2023, në vlerën 22.67 euro dhe me balancë në datë 12.01.2023, në vlerën 30 euro.

✓ **Konfirmohet deklarimi me sqarimet dhe dokumentacion e dorëzuar në lidhje me llogaritë bankare të deklaruara nga Juvena Kuti, pranë ING Bank, Bruksel.**

59 **Llogari depozite bankare** në Raiffeisen Bank, mbyllur në vitin 2016.

Burimi, depozituar nga prindërit.

59.1 Raiffeisen Bank, me shkresën nr. **** prot., datë 07.08.2023, ka bashkëlidhur CD të llogarive bankare të Juvena Kuti, ku konfirmohet llogari në lekë, për periudhën 2012 deri në vitin 2016. Konstatohen kreditime nga Sami dhe Vehbije Kuti, në vlera të vogla për periudhën si më sipër.

✓ **Konfirmohet deklarimi me Raiffeisen bank.**

- 60 **Llogari bankare** në Raiffeisen Bank, me gjendje në datë 20.02.2023, shuma 4.612 euro, në llogari rrjedhëse dhe 0 euro, në llogari kursimi.
Burimi, të ardhura nga puna ime.
Vlera 4.627 euro.

60.1 Me inventarin e datës 05.01.2024, subjekti ka dorëzuar nxjerrjen e llogarisë nga Raiffeisen Bank Zagreb, datë 30.11.2023, ku konfirmon llogari në euro në emër të Juvena Kutit, me balancë në datë 20.02.2023, në vlerën 4.612 euro.

✓ **Subjekti ka dorëzuar dokumentacionin në lidhje me llogarinë bankare të Juvena Kutit pranë Raiffeisen Bank Zagreb.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- 1) Të ardhura nga puna si studente, për periudhën 08.09.2015 - 30.09.2015, 01.10.2015 - 02.10.2015 dhe 03.11.2015 - 06.11.2015, në subjektin “Laurenty Sa”, Bruksel. Vlera 1.347 euro.
- 2) Të ardhura nga puna si studente, për periudhën 01.08.2016 - 31.08.2016, në subjektin “Laurenty Sa”, Bruksel. Vlera 1.180 euro.
- 3) Të ardhura nga puna si studente, për periudhën 07.04.2017 - 30.06.2017, në subjektin “Khoi Nguyen Srlp”, Bruksel. Vlera 1.370 euro.
- 4) Të ardhura nga puna si studente, për periudhën 04.09.2017 - 29.09.2017, në subjektin “Laurenty Nettoyage Sa Ouvriers Bruxelles”, Bruksel. Vlera 1.027 euro.
- 5) Të ardhura nga puna si studente, për periudhën 01.11.2017 - 31.01.2018, në subjektin “De Pistolei-Fdab Sprl”, Bruksel. Vlera 1.700 euro.
- 6) Bursë nga Qeveria Flamane e shtetit Belg, për programin e Komisionit Europian, Erasmus+, për periudhën 07.02.2018 deri 07.06.2018, në Burgos, Spanjë. Vlera 1.087 euro.
- 7) Të ardhura nga puna si studente, për periudhën Korrik 2018 - Shtator 2018, në subjektin “Laurenty Nettoyage Sa”. Vlera 1.775 euro.
- 8) Të ardhura nga puna si studente, për periudhën Mars - Qershor 2019, në subjektin “De Pistolei-Fdab Sprl”, Bruksel. Vlera 729 euro.
- 9) Të ardhura nga puna ime për periudhën Korrik - Dhjetor 2019, në subjektin “Viet's Parel”, Bruksel. Vlera 8.912 euro.
- 10) Të ardhura nga puna ime për periudhën Shtator 2021 - aktualisht, në subjektin “Balkan Express D.o.o”, Zagreb (Punëdhënësi i lartpërmendur, në bazë të marrëveshjes me subjektin Euroing, me ka huazuar në degën Belge të kësaj të fundit, për të kryer shërbimet e kontraktuara në bazën ajrore të Kleine Brogel, Peer, Belgjikë). Vlera 63.596 HRK dhe 1240 euro.

- 61 Me inventarin e datës 05.01.2024, subjekti dha sqarime të hollësishme me shkrim, si dhe ka dorëzuar dokumentacion justifikues, në lidhje me të ardhurat e vajzës, si vijon:
- Statement nga ING Bank, ku konfirmohen kreditimet në euro.

- Kopje pagesash (17 pagesa) nga Balkan Express D.o.o, për periudhën 08.10.2021 - 27.01.2023, në vlerën totale 1.240 euro dhe 63.596 Hrk.
 - Transaksion bankar (në gjuhën Angleze), datë 05.03.2018, ku rezulton se në llogarinë e Juvena Kuti, kreditohet vlera 1.087 euro.
- ✓ **Të ardhurat e Juvena Kuti, për periudhën Shtator 2015 - Janar 2023, rezultojnë në vlerën totale 19.540 euro dhe 63.596 Hrk (kuna) konvertuar rreth 3.200.000 lekë.**

DETYRIME FINANCIARE

62 Kartë krediti në ING Bank, detyrimi 281.6 euro.

62.1 Me inventarin e datës 05.01.2024, subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, ku sqaron se në dokumentin bashkëlidhur (pasqyra e shpenzimeve kartë krediti ING Bank), për periudhën 28.01.2023 - 27.02.2023, detajohet pasqyrimi i blerjeve të kryera me këtë kartë, si dhe detyrimi e gjendja hapëse/mbyllëse e periudhës në bazë të të cilave është bërë përlllogaritja e detyrimit të deklaruar.

62.2 Bashkëlidhur subjekti ka dorëzuar nxjerrje llogarie bankare nga ING Bank, datë 27.02.2023, ku konfirmon në emër të Juvena Kuti, llogari kartë krediti me limit 1.000 euro. Periudha e paraqitur 27.01.2023 - 27.02.2023, ku konstatohen lëvizje të ndryshme në llogarinë e kartës së kreditit gjatë kësaj periudhe.

✓ **Konfirmohet deklarimi me sqarimet dhe dokumentacionin e dorëzuar.**

63 Kartë krediti në Raiffeisen Bank, detyrimi 0 euro.

63.1 Në lidhje me kartën e kreditit të vajzës në Raiffeisen Bank, nëpërmjet inventarit të datës 05.01.2024, subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, ku sqaron se në momentin e hapjes së llogarisë pranë Raiffeisen Bank, vajza është pajisur me një kartë debiti dhe një kartë krediti. Karta e kreditit nuk është aktivizuar asnjëherë dhe detyrimisht as është përdorur. Duke qenë se aktivizimi nuk ka ndodhur, karta është konsideruar si inekzistente nga vetë banka, si dhe është konfirmuar nga vetë Raiffeisen Bank.

63.2 Subjekti ka dhënë sqarime, si dhe ka dorëzuar dokumentacion, në lidhje me kërkimin e bërë nga ana e vajzës nëpërmjet e-mailit, në lidhje me kartën e kreditit në Raiffeisen Bank.

✓ **Konfirmohet se Juvena Kuti ka llogari bankare aktive në euro, në Raiffeisen Bank.**

DEKLARIMI I DJALIT - SEJVI KUTI

DEKLARIMI 1 PASURIVE

64 **Llogari bankare** në ING Bank, krijuar në mars 2016, me gjendje në datë 12.02.2023, vlera 104 euro në llogari rrjedhëse, vlera 147 euro në llogari investimi dhe vlera 0 euro në llogari kursimi.

Burim: të ardhura nga puna si student dhe kursime nga të ardhurat e familjes.

Vlera: 252 euro.

Zotëron: 100 %.

64.1 Me inventarin e datës 05.01.2024, subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, ku sqaron se në dokumentin bashkëlidhur jepet fillimisht gjendja në datë 10 Shkurt 2023 (vlera 136,3 euro) dhe transaksionet e bëra. Për vlerën 147 euro, në llogari investimi të djalit, sqaron se në dalë 12.02.2023 djali ka pasur 24 aksione AMC Entertainment holdins INC "A " dhe 2 aksione Insmmed, në shumën totale 146.81 euro. Bashkëlidhur subjekti ka dorëzuar nxjerrje llogarie nga ING Bank, për llogari në euro në emër të Sejvi Kuti.

✓ **Subjekti ka dhënë sqarime, si dhe ka paraqitur dokumentacion në lidhje me llogaritë e deklaruar në emër të Sejvi Kuti.**

65 **Llogari në Revolut**, krijuar në Gusht 2019 (nën optikën e monedhave digjitale), me investim në Mars dhe Shtator 2021, gjithsej 80 euro, me vlerë monetare në datë 12.02.2023 prej 23 euro.

Burimi: të ardhura nga puna si student dhe kursime nga të ardhurat e familjes.

Vlera: 23 euro.

Zotëron: 100 %

65.1 Me inventarin e datës 05.01.2024, subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, në lidhje me llogarinë në Revolut, me vlerë 23.32 Euro, në datë 12.02.2023, ku sqaron se llogaria është mbyllur në datë 02.06.2023. Bashkëlidhur nxjerrje llogarie nga Revolut Bank, datë 02.06.2023, ku konfirmon llogari në euro në emër të Sejvi Kuti, periudha 01.01.2023 - 02.06.2023, vlera 0 euro.

✓ **Subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues në lidhje me llogarinë e djalit në Revolut Bank.**

66 **Llogari depozite bankare** në Raiffeisen Bank, mbyllur në vitin 2016.

Burimi: depozituar nga prindërit.

66.1 Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 07.08.2023, ka bashkëlidhur CD të llogarive bankare të Sejvi Kuti, ku konfirmohet llogari “kid” në lekë, për periudhën 2012 deri në vitin 2016. Konstatohen kreditime nga Sami dhe Vehbije Kuti, në vlera të vogla, për periudhën si më sipër. Llogaria rezulton e mbyllur.

✓ **Konfirmohet deklarimi me përqijqjen e Raiffeisen Bank.**

67 DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- 1) Të ardhura nga puna si student, për periudhën 24.07.2017 — 26.08.2017, në subjektin “Laurenty Nettoyage Sa”. Vlera 2.064 euro.
- 2) Të ardhura nga puna si student, për periudhën 30.07.2018 — 31.08.2018 dhe 03.09 — 14.09.2018, në subjektin “Laurenty Nettoyage Sa”. Vlera 1.888 euro.
- 3) Të ardhura nga puna si student, për periudhën 01.07.2019 — 31.07.2019, në subjektin “Laurenty Nettoyage Sa”. Vlera 1.337 euro.
- 4) Të ardhura nga puna si student, për periudhën nëntor 2019 — Shkurt 2020, në subjektin “Avis Recruit a Student Project”. Vlera 799 euro.
- 5) Të ardhura nga puna si student, për periudhën Korrik 2020 — nëntor 2022, në subjektin “Louis Delhaize — ProXlr Sprl — Leclair Srl”. Vlera 8.206 euro.

67.1 Subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, në lidhje me të ardhurat e djalit si student, nga puna. Bashkëlidhur ka dorëzuar nxjerrje llogarie nga ING Bank, për llogari në euro në emër të Sejvi Kuti, për periudhën 07.08.2017 - 29.11.2022, ku konfirmohen kreditimet nga Laurenty Sa, në vlerën totale 5.408 euro, nga Recruit a Student Project, në vlerën totale 830 euro, nga Leclair Srl në vlerën totale 113 euro dhe nga Proxlr Srl, në vlerën totale & 8.083 euro.

✓ **Të ardhurat e Sejvi Kuti, për periudhën Gusht 2017— Nëntor 2022, janë në vlerën totale rreth 14.434 euro, konvertuar rreth 1.651.000 lekë.**

68 Banka e Shqipërisë, BKT, Tirana Bank, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Pro Credit Bank Banka e Parë e Investimeve, Banka Amerikane e Investimeve, Union Bank, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, Landeslease, RFZ Invest, Credins Invest Easyway, Fondi BESA Institucioni Financiar NOA, Iutecredit Albania Kredo Financë, konfirmojnë se subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk janë klientë të tyre, ç’ka konfirmohet me deklarinimin.

69 Drejtoritë dhe Zyrat Vendore të ASHK-së, dhe konkretisht: Tiranë Rurale 2, Tiranë Rurale 1; Tiranë-Veri; Kurbin; Shkodër; Vlorë; Korçë; Lezhë; Fier; Berat; Gjirokastër; Pogradec; Kamëz-Vorë; Lushnjë; Kuçovë; Malësi e Madhe, Gramsh; Kavajë; Elbasan; Kolonjë; Has; Skrapar; Kukës; Durrës; Tropojë; Bulqizë; Pukë; Peqin; Mirditë; Tepelenë; Përmet; Krujë; Devoll; Zonat e Stimuluara; Librazhd; Mat; Dibër, Mallakastër, Sarandë, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara apo në proces legalizimi në emër të subjektit dhe personave të lidhur.

70 Credins Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2023, konfirmon në emër të Sejvi Kuti, llogari për fëmijë në lekë, ku konstatohen kreditime nga shkolla Dëshmorët e Lirisë, për periudhën 2010 - 2011, në vlerën totale 27.000 lekë. Llogaria rezulton e mbyllur.

71 OTP Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 04.08.2023, konfirmon se shtetasja Vehbije Kuti, ka pasur llogari në lekë pranë OTP Bank (duke qenë se Alpha Bank është përthithur nga OTP Bank, duke filluar nga data 01.12.2022, banka ka dhënë informacionin edhe mbi llogaritë që klientët kanë pasur në dy sisteme bankare) nga data 02.03.2009 deri në datën e mbylljes së llogarisë. Bashkëlidhur tabela e llogarisë në lekë, në emër të Vehbije Kuti, ku konstatohet se

në datën 29.9.2009, maturohet depozitë në vlerën 400.000 lekë dhe në të njëjtën datë kreditohet nga I. K. vlera 325.000 lekë, dhe hapet depozitë në vlerën 500.000 lekë. Kjo depozitë maturohet në datën 29.03.2010, dhe në datën 26.04.2010 tërheq nga llogaria 511.000 lekë. Llogaria rezulton e mbyllur.

71.1 Me inventarin e datës 05.01.2024 subjekti ka dorëzuar sqarime me shkrim, ku sqaron se në datën 29.09.2008, bashkëshortja, ka hapur një llogarisë bankare pranë Alpha Bank. Pas maturimit të depozitës prej 400.000 lekësh, bashkëshortja ka bërë një tërheqje, dhe, si duket, për të siguruar interesin nga një depozitë me vlerë minimale 500.000 lekë, është bërë një kreditim prej 325.000 lekë, nga babai i tij. Burimet e depozitës kanë qenë nga të ardhurat dhe kursimet e tyre familjare. Të ardhurat e babait, kanë qenë nga kursimet e akumuluar në vite nga pensioni i tij, përpara depozitimit në bankë (babai ka dalë në pension rreth vitit 1993). Destinacioni pas tërheqjes kanë qenë shpenzime të ndryshme sipas nevojave familjare.

✓ **Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me burimin e depozitës bankare të bashkëshortes në OTP Bank, në vlerën 500.000 lekë, si dhe destinacionin e përdorimit të saj pas tërheqjes, për nevoja të ndryshme familjare.**

72 Credins Invest me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon në emër të Vehbiye Kuti, fonde pensioni, me balancë në datën 09.03.2023, në vlerën 55.846 lekë.

72.1 Me inventarin e datës 05.01.2024, subjekti ka dorëzuar sqarime me shkrim, ku sqaron se në vitin 2018, bashkëshortja ka lidhur kontratë me Credins Invest, për derdhjen nga paga mujore e saj, të një kontributi mujor, si fond pensioni, me vlerë 1.000 lekë/muaj. Kjo vlerë mbahet çdo muaj nga paga e bashkëshortes dhe përkthehet në kuota pensioni.

✓ **Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me fondet e investimit të bashkëshortes në Credins Invest.**

73 Unioni Financiar Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 18.08.2023, konfirmon në emër të Sami Kuti, 3 (tre) dërgesa në vlerën totale 2.500 euro.

73.1 Me inventarin e datës 05.01.2024, subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, ku sqaron se për mbështetjen e fëmijëve, gjatë periudhës së Covid 19, i'u kanë dërguar fëmijëve nëpërmjet Western Union, respektivisht 600 euro në datë 04.03.2020, 600 euro datë 19.03.2020 dhe 1.300 euro në datë 20.05.2020.

73.2 Bashkëlidhur subjekti ka dorëzuar mandate pagesash nga Western Union, (3 mandate), për periudhën 04.03.2020 - 20.05.2020, ku rezulton se Sami Kuti ka dërguar për Juvena Kuti gjithsej 1.900 euro dhe për Sejvi Kuti 600 euro.

✓ **Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me konfirmimin e Unionit Financiar Tiranë, dërguar fëmijëve të tij, jashtë vendit.**

74. DPT, me shkresën nr. V-prot., datë 07.08.2023, konfirmon se subjekti apo personat e lidhur nuk figurojnë të regjistruar pranë organeve tatimore, për ushtrimin e ndonjë aktiviteti private.

75. QKB, me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, nuk konfirmon të regjistruar subjekte tregtare në emër të subjektit apo personave të lidhur.

76. ISSH, me shkresën nr. *** prot., datë 11.08.2023, konfirmon shtetasi I. K., nga muaji dhjetor 1993, përfiton pension pleqërie në masën mujore aktuale 17.972 lekë dhe shtetasja H. K., nga muaji maj 1993, përfiton pension pleqërie në masën mujore aktuale 17.972 lekë.

77. ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën nr. V-prot., datë 18.08.2023, ka bashkëlidhur vërtetime për vjetërsinë në punë për shtetasit E. K., periudha e punës 1965 -1991 dhe H. K., periudha e punës 1980 - 1990.

78. Drejtoria e Përgjithshme Detare, me shkresën nr. *** prot., datë 11.08.2023, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të subjektit apo personave të lidhur.

79. Trupa e Vlerësimit kreu analizën me qëllim evidentimin e mundësisë finaciare për krijimin e pasurive të deklaruara nga subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, nga ku rezultoi se kanë patur të ardhura të mjaftueshme për të kryer shpenzimet e deklaruara dhe për të justifikuar burimin e krijimit të pasurive të trajtuara më lart.

80. Për periudhën Shtator 2000 — Mars 2023, referuar treguesve statistikorë të INSTAT, janë shpenzuar minimalisht për konsum personal (familjar), rreth 8.950.000 lekë. *(Në këtë vlerë nuk janë përfshirë periudhat si vijon: Për Sami Kuti, periudha Janar 2014 — Korrik 2016, për Vehbiye Kuti, periudha Tetor 2005 — Prill 2006, Korrik 2013 — Korrik 2016 dhe Nëntor 2019 — Nëntor 2020, për fëmijët Juvena dhe Sejvi Kuti, periudha Korrik 2013 dhe në vazhdim).*

NË PËRFUNDIM TË HETIMIT TË KRYER MBI VLERËSIMIN E PASURISË,

81. Trupa e Vlerësimit ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, bazuar në parimin e kontradiktoritetit dhe në shpjegimet e subjektit z. Sami Kuti, arriti në konkluzionin se:

- ✓ **Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e liqjshme financiare;**
- ✓ **Nuk ka mungesë të burimeve financiare të liqjshme për të justifikuar pasuritë;**
- ✓ **Nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- ✓ **Nuk është kryer deklarim i rremë;**
- ✓ **Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

B. KONTROLLI I FIGURËS

82. Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

83. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre elementë:

- (i) *Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të Nenit 36, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;*
- (ii) *Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;*
- (iii) *Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të Nenit 36, pika 3, gërmra (ë), të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.*

84. Subjekti i vlerësimit, z. Sami Iljaz Kutli, në zbatim të Nenit 36, pika 2, të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në datën 09.03.2023.

85. Për kontrollin e figurës Trupa e Vlerësimit administroi:

- a. Deklaratën e Kontrollit të Figurës;
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

86. Në përputhje me nenin 42, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, është përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit raporti nr. *** Prot., datë 05.02.2024, i përpiluar me përgjigjet e ardhura nga institucionet publike dhe ato ligjzbatuese, verifikuese dhe informuese, ku është konstatuar përshtatshmëria e subjektit të vlerësimit z. Sami Iljaz Kutli.

87. Në deklaratën “Kontrolli i Figurës”, subjekti i vlerësimit ka deklaruar si vijon:

- a. Në pjesën e parë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat identifikuese.
- b. Në pjesën e dytë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për vendbanimin.
- c. Në pjesën e tretë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për arsimimin dhe kualifikimet.
- d. Në pjesën e katërt të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për punësimin.
- e. Në pjesën e pestë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për sigurinë, si më poshtë vijon:

- 1) Nuk është dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
- 2) Nuk ka qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj.
- 3) Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale.
- 4) Ndaj tij nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi.
- 5) Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- 6) Ndaj tij nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- 7) Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij, bashkëshortja dhe fëmijët, të jetë përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- 8) Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
- 9) Nuk është në dijeni nëse ndonjë nga anëtarët e familjes së tij të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- 10) Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- 11) Nuk ka dijeni nëse një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- 12) Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- 13) Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- 14) Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- 15) Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- 16) Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- 17) Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish-shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
- 18) Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike.
- 19) Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- 20) Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit.

88. Po ashtu, subjekti ka nënshkruar edhe dy vetë-deklarimet për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

HETIMI ADMINISTRATIV

89. Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektit të vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet duke kërkuar të dhëna nga institucionet agjencitë ligj zbatuese, ku ka rezultuar si vijon:

90. **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile** me shkresën “E Paklasifikuar”, Nr. *** Prot., datë 15.08.2023, bën me dije se nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit Z. Sami Iljaz Kuti, si dhe nuk ka ndryshuar apo marrë shtetësi tjetër.

91. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “I Kufizuar”, Nr.*** Prot., datë 09.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Sami Iljaz Kuti, bën me dije se nuk rezultoi i dënues.

92. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “Sekret”, Nr. *** Prot., datë 09.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Sami Iljaz Kuti, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- Nuk kanë të dhëna në lidhje me cenimin e sigurisë kombëtare, apo aktivitet të kundërligjshëm.

93. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “I kufizuar” Nr. *** datë 18.08.2023, për subjektin e vlerësimit, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- Nuk kanë të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
- Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”) ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj;
- Nuk kanë të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (persona të dënues ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar).
- Nuk kanë të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepr penale;
- Nuk kanë të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepr penale;
- Nuk kanë të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;
- Nuk kanë të dhëna nëse gjatë 10 viteve të fundit është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS;
- Nuk kanë të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet;
- Nuk ka procedim disiplinor apo masë disiplinore.

94. **Institucion ligjbatues**, me shkresën “Konfidencial”, Nr. *** Prot., datë 11.08.2023; për subjektin e vlerësimit Z. Sami Iljaz Kuti, bën me dije se nuk disponon të dhëna.

95. **Institucion ligjbatues** me shkresat “Sekret” datë 03.08.2023 dhe datë 06.10.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Sami Iljaz Kuti dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- Nuk kanë të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm;
- Nuk ka procedime penale të referuara;
- Për subjektin e vlerësimit nuk disponohen ankesa, të dhëna ose informacione që lidhen me objektin e kërkesës.

96. **Institucion ligjbatues**, me shkresat “I Kufizuar”, Nr. *** Prot., datë 31.10.2023 dhe datë 29.05.2024, për subjektin e vlerësimit Z. Sami Iljaz Kuti, bën me dije se:

- Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi;
- Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal;
- Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
- Nuk ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.

97. **Institucioni ligjbatues**, me shkresat “I kufizuar”, Nr. *** Prot., datë 02.08.2023 dhe datë 02.05.2024; bën me dije se për subjektin e vlerësimit Z. Sami Iljaz Kuti, nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

98. **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar**, me shkresën “I Kufizuar”, Nr. *** Prot., datë 15.08.2023; për subjektin e vlerësimit Z. Sami Iljaz Kuti, bën me dije se:

- Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), nivelin “Tepër Sekret” lëshuar më datë 29.06.2022, e vlefshme deri më datë 28.06.2027.
- Nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP.
- AKSIK nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

99. **Avokati i Popullit** me shkresën “E Paklasifikuar”, Nr. *** Prot., datë 14.08.2023; për subjektin e vlerësimit Z. Sami Iljaz Kuti, bën me dije se:

- Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

100. **Institucioni ligjbatues**, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot., datë 24.11.2023; për subjektin e vlerësimit Z. Sami Iljaz Kuti, bën me dije se nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh,

terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri 2 Korrik 1991.

Testi për përdorim lëndësh narkotike:

101. Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara nga testimi për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se **nuk u zbulua** prania e produkteve të testuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

102. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45 dhe 47, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Gardës së Republikës.

103. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
- Raportin e përgatitur nga Garda e Republikës sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

104. Garda e Republikës, në përputhje me nenin 46 pika 2, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar, ka përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit, për subjektin e vlerësimit z. Sami Kuti, raportin e vlerësimit të aftësive profesionale me Nr. *** Prot., datë 26.09.2023, të përpiluar në mënyrë të hollësishme dhe të arsyetuar, në të cilin është konstatuar se:

104.1 Punonjësi i Policisë Z. Sami Iljaz Kuti është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme, duke rezultuar i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban.

HETIMI ADMINISTRATIV

105. Subjekti i vlerësimit Z. Sami Iljaz Kuti, në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse, pranë Gardës së Republikës.

106. Në zbatim të pikës 2 dhe 3 të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, ku përcaktohet se periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e

emërimit të punonjësit në gradën/pozicionin që mban, jo më shumë se 5 (pesë) vjet. Subjekti i vlerësimit Sami Kuti, nga viti 2018 e deri aktualisht, ka qenë pjesë e Gardës së Republikës.

107. Vlerësimi i aftësive profesionale mbështetet në:

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit;
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të Nenit 44, pika 1, Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, të mbështetura në dokumentacionin shoqërues të dorëzuara nga vetë subjekti;
- Të dhënat që konfirmojnë nivelin e arsimor, ecurinë në karrierë dhe gradë, trajnimet, kualifikimet, vlerësimet individuale të punës si dhe performancën e konstatuar gjatë kontrolleve, inspektimeve apo ankesave në drejtim të subjektit nga Drejtoria e Standardeve Profesionale apo institucioneve të tjera mbikëqyrëse.

Në Formularin e Aftësive Profesionale subjekti deklaron:

108. **Të dhëna për Arsimimin:**

108.1 Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimit dhe përshtatshmëria me kriteret e pozicionit të punës, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2/a, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

108.2 Pas administrimit të kopjes së dosjes personale të punonjësit, subjekti i vlerësimit rezulton se ka arsimin si më poshtë:

- 1983 – 1987: Shkolla e Mesme e Përgjithshme “29 Nëntori”, Shkodër;
- 1988 – 1992: Akademia ushtarake “Skënderbej” Tiranë.

108.3 Pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar, punonjësi Sami Kuti, subjekt vlerësimi:

✓ **Subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që ushtron pranë Gardës së Republikës, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.**

109. **Certifikatat e trajnimeve, kualifikimeve dhe medaljet**

109.1 Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit, të përcjella me raportin e vlerësimit të aftësive profesionale, rezulton se ai ka kryer trajnimet, si më poshtë vijon:

- Kursi për përparim në gradë e karrierë, për gradat e larta, **Drejtues i parë** (Kolonel) të Gardës së Republikës, Akademia e Sigurisë — në vitin 2020.
- Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm, **Master i Nivelit të parë** “Studime në Fushën e Mbrojtjes” Akademia e Mbrojtjes — 14.09.2009 deri 25.06.2010.
- **Medalje** “Për shërbime ushtarake”, akorduar nga Presidenti i Republikës me motivacionin “Për punë me përkushtim dhe profesionalizëm në shërbimet logjistike

mbështetëse për strukturat operative në kryerjen e detyrës për ruajtjen e sigurimin e personaliteteve të larta shtetërore” - 18.06.2010.

109.2 Nga verifikimi i të dhënave të administruara, rezulton se:

- ✓ **Deklarimi i subjektit të vlerësimit është i saktë.**
- ✓ **Subjekti ka kryer trajnime/specializime, si dhe ka marrë medalje për shërbime ushtarake, në përputhje me funksionin që ushtron.**

110. Vlerësimet e punës

110.1 Nga dokumentacioni i dorëzuar pranë trupës së vlerësimit, për periudhën 2018-2022, nga ku janë administruar 4 (katër) vlerësime të aftësive individuale të punës (nga 5 (pesë) që duhej të ishin), si dhe bazuar në sistemin e vlerësimit dhe pikëzimit të rezultateve të punës për performancën vjetore, rezulton se subjekti është vlerësuar në të katër vitet me pikët maksimale për punën e kryer, si më poshtë vijon:

Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 2017-2018	98 Pikë	(shumë mirë)
Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 2018-2019	94 Pikë	(shumë mirë)
Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 2019-2020	94 Pikë	(shumë mirë)
Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 2020-2021	100 Pikë	(shumë mirë)

110.2 Në vlerësimet e mësipërme vlen të theksojmë se vlerësimi maksimal i punonjësve sipas formularit të vlerësimit është me 100 pikë.

110.3 Vlerësimi i aftësive individuale të punës sipas standardeve të përcaktuara bëhet nga eprori i drejtpërdrejtë, bazuar në vlerësimin e integritetit, profesionalizmit, komunikimit, qëndrimit konstruktiv, paanshmërisë, punës në grup si dhe planifikimit dhe organizimit të punës.

110.4 Bazuar në vlerësimet e mësipërme të administruara nga trupa e vlerësimit, konkludohet:

- ✓ **Deklarimi i subjektit të vlerësimit është i saktë.**
- ✓ **Subjekti ka përmbushur detyrat profesionale, ka respektuar rregullat e etikës, si edhe ka shfaqur performancë të lartë funksionale.**

111. Masat disiplinore

a. Referuar raportit të dërguar nga Garda e Republikës, ku konfirmon se ka verifikuar dokumentacionin në dosjen personale të subjektit, rezulton së gjatë periudhës 5 vjeçare, (2018-2022) të përcaktuar në pikën 2, të nenit 44, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit:

- ✓ **Nuk është ndëshkuar me masë disiplinore.**
- ✓ **Deklarimi i subjekti është i saktë.**

112. Ecuria në karrierë

112.1 Nga verifikimi i kryer nga trupa e vlerësimit rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare, subjekti Sami Kuti, ka ecurinë në karrierë, si vijon:

- Zëvendësdyrëtor i Përgjithshëm në Gardën e Republikës së Shqipërisë 02.02.2024 – aktualisht.
- Me Urdhër Nr. 96, datë 31.05.2024 të Ministrit të Brendshëm, Drejtuesi i Parë Sami Kuti është caktuar për ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë.
- Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse 18.09.2020 – 01.02.2021.
- Shef i Sektorit Logjistik 05.07.2018 – 18.09.2020.
- Shef i Sektorit të Mbështetjes me Logjistikë (Ai dhe Zv/Kryetar Dege) Shkurt 2018-18.09.2020.

112.2 Në lidhje me përputhshmërinë e gradës me funksionin/pozicionin e punë, subjekti i vlerësimit ka përfituar gradat si më poshtë:

- Nëntoger 10/08/1992
- Kapiten i Parë 01/11/1998
- Major 06/03/2006
- Nënkolonel 07/01/2011
- Nënkolonel 16/10/2016 (i ri-jepet)
- Kolonel 18/09/2020
- Drejtues i Parë 01/12/2021

112.3 Në përfundim, në lidhje me ecurinë në karrierë të z. Sami Iljaz Kuti, bazuar në deklaratimet e bëra, verifikimet nga dokumentacioni i administruar, trupa e vlerësimit konkludon se:

- ✓ **Funksionet në të cilat është emëruar subjekti dhe gradat e përfituara gjatë karrierës, janë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.**

113. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshop-e, seminare, botime brenda dhe jashtë vendit.

113.1 Subjekti i vlerësimit, z. Sami Iljaz Kuti, për periudhën e përcaktuar në formularin e aftësive profesionale, nuk ka marr pjesë në ndonjë konferencë, workshop, seminar apo botim brenda dhe jashtë vendit.

NË PËRFUNDIM TË HETIMIT TË KRYER PËR VLERËSIMIN E AFTËSIVE PROFESIONALE,

114. Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Gardën e Republikës së Shqipërisë, arrin në konkluzionin se, subjekti i vlerësimit z. Sami Kuti:

- ✓ **Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;**
- ✓ **Ka rezultuar i kualifikuar për të ushtruar atë funksion që mban;**
- ✓ **Ka vlerësime pozitive pune.**

KONKLUSIONE PËRFUNDIMTARE

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatores së çështjes, shpjegimet me shkrim të dhëna nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe pasi u njoh me qëndrimin e subjektit të vlerësimit në seancën dëgjimore publike të datës 19.07.2024, ftoi subjektin në seancën e dhënies së vendimit të datës 25.07.2024, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, z. Sami Iljaz Kuti, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- ***Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;***
- ***Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;***
- ***Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.***

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, z. **Sami Iljaz Kuti**, me funksion Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Gardës së Republikës së Shqipërisë.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Gardës së Republikës brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.

3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 25.07.2024.

TRUPA E VLERËSIMIT

Erjana PJETRI

Kryesuese

Ersa KARAJ

Relatore

Klevis DHIGOI

Anëtar